



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**“Biologji”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Ismail Qemali, Vlorë”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**


**Prof. Aleko MIHO**

**Prof. Ilija MIKEREZI**

**Maj - 2021**

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bsc në “Biologji” të ofruar nga Universiteti “Ismail Qemali”,**  
**Vlorë**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Biologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Biologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 124, datë 17.2.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i Studimit
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite (6 Semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	21 PAE/3 PAK
18	Numri i studentëve:	17 studentë në v.a. 2018-2019 12 studentë në v.a. 2019-2020 20 studentë në v.a. 2020-2021
19	Komente / të tjera:	

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit Bachelor në 'Biologji', zhvillohet në kujdesin e Departamentit të Biologjisë (DB), njësi bazë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore (FSHTN), në Universitetin e Vlorës 'Ismail Qemali' (UVI). UVI është një institucion relativisht i ri në sistemin e IAL-ve në Shqipëri, i themeluar në 1994, mbështetur kryesisht në traditën arsimore të nëparshme në këtë qytet. Si DB dhe Programi nën shqyrtim është gjithashtu i ri, i hapur në vitin 2010. Programi është përbushje e drejtëpërdrejtë e misionit të DB, dhe në përputhje me interesat kombëtare, me Ligjin 80/2015, Statutin e UVI (2019), dhe Planin Strategjik 2018-2024 të UVI. UVI është akredituar nga ASCAL me Vendimin 50/2020 deri në vitin 2025.

DB në vitin 2019-2020 ka gjithsej 15 personel akademik, 10 të brendshëm (2 Prof.asoc., 5 Dr dhe 3 MSc), 2 punonjës ndihmës. Kurse i gjithë Personeli akademik i Programit përbëhet nga 21 efektivë (3 Prof.asoc, 10 Dr, 8 asistent-lektorë MSc), dhe 3 punonjës me kontratë (1 Prof.asoc dhe 2 MSc). Në dispozicion për mësimdhënien e Programit janë 5 laboratorë (Botanikë, Zoologji, Mikrobiologji, Qendra Kërkimore Shkencore, Kimi dhe Informatikë), përveç mjedisve të përbashëta të auditorëve dhe 3 bibliotekave. RVB pohon se hapësira në dispozicion të studentit në FSHTN është 2.9 m<sup>2</sup>/student, në përputhje me VKM 418/2017. Rreth 137 studentë janë regjistruar në vitin e parë të Programit në katër vitet e fundit: 63 në v.a. 2016-2017, 25 në 2017-2018, 17 në 2018-2019, 12 në 2019-2020 dhe 20 në 2020-2021. Janë diplomuar gjithsej në Program 179 studentë, 55 në 2016-2017, 46 në 2017-2018, 58 në 2018-2019, dhe 20 në 2019-2020.

Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS, në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM 41/2018; VKM 879/2019; U1-MASR/2020). Ofron njohuri dhe kompetenca bazë në shkencat biologjike (botanikë, zoologji, mikrobiologji, fiziologji, gjenetikë, biokimi, biologji molekulare etj.), i harmonizuar mirë me të dyja programet e masterit të ciklit të dytë të DB. Programi është saktësisht i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas elementëve të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore, praktika etj. Studentët që diplomohen në këtë Program mund të ndjekin programet e cikleve të dyta pranë DB, në Master Profesional "Mësuesi AM në Biologji me Profil Minor në Kimi", si dhe Master Shkencor në "Biologji Mjedisore", dhe në MSc të ngjashëm në IAL të tjera në vend dhe jashtë vendit.

DB dhe gjithë institucioni bëjnë përpjekje për të nxitur dhe rritur cilësinë e mësimdhënies dhe të stafit mësimor. Kjo nëpërmjet raporteve vjetorë, pyetësorëve, pjesëmarrjes në projekte kërkimore, në nxitjen e lëvizjeve të personelit akademik dhe studentëve jashtë shtetit etj. Në UVI funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit (NJSBCVI), me funksion për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Institucionika një Sistem Menaxhimi (UVMS), përfshirë dhe Platformën *e-learning*, që bën të mundur komunikimin e personelit akademik me studentët gjatë gjithë procesit mësimor.

Si Grup vlerësues i jashtëm (GVJ), **vlerësimi ynë në tërësi është pozitiv për Programin nën shqyrtim**. Megjithatë, DB dhe vetë institucioni duhet të kenë parasysh dhe përpiqen për të fuqizuar ose përmirësuar disa mangësi që vumë në shqyrtimin e Dosjes, Raportin e GVB, dhe nga takimet *online* me gjithë palët në UVl. Konkretisht: a) Vihet re rënie e theksuar e numrit të studentëve të regjistruar në Program në vitet e fundit; për këtë, nevojitet një njohje më e mirë e tregut të punës në Qarkun e Vlorës, dhe përpjekje për përshtatje të Programit, dhe Programeve master në vijim në përputhje me nevojat e tregut të punës në zonë. b) Programi i studimit është relativisht i ngjashëm me Programe të tjera të ngjashme në vend, por si ky Program, ashtu si dhe të tjera Programe të ngjashme në vend, kanë nevojë të përshtatin Programin dhe Planet mësimore përkatëse me të tillë të ngjashëm në rajonin europian, sidomos në vendet e BE, duke u mbështetur në universitetet më me përvojë. Po kjo mund të thuhet edhe për Syllabuset lëndore, dhe literaturën mbështetëse të tyre. c) DB ka personel akademik dhe ndihmës në numër dhe kualifikim pjesërisht të mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e kohës lidhur me cilësinë së mësimdhënies së Programit. Në vite janë vënë re disa largime të personelit të ri. Vihet re mbingarkesë mësimore e personelit ekzistues, mbulim lëndësh bazë të fushave jo shumë të afërta nga i njëjti titullar, dhe mbulim lëndësh bazë nga titullarë pa gradë shkencore. Kjo kërkon gjetjen e mënyrave për shtimin dhe motivin më shumë të personelit akademik, dhe sidomos për nxitjen dhe mbështetjen e kualifikimit shkencor të personelit të ri.

Disa prej këtyre komenteve i përkasin jo vetëm Njësisë bazë, DB, dhe Institucionit, UVl, por dhe vetë Ministrisë përgjegjëse, MASR, dhe mund të pohojmë se janë vërejtur edhe në analiza të tjera të ngjashme të kryera prej nesh për ASCAL.

### **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka në përbërje Prof. Aleko Miho, ekspert i biologjisë së ruajtjes (botanikë), Universiteti i Tiranës, dhe Prof. Ilija Mikerezi, ekspert igjenetikës së popullatave, Universiteti i Tiranës. Grupi kreu fillimisht një kualifikim të shpejtë pranë ASCAL, ku u njoh me procedurën dhe gjithë materialet në dispozicion, të përgatitura nga Njësia përgjegjëse për Programin e studimit nën shqyrtim. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup punoi me asistues dhe nga Dr. Xhiliola Bixheku, Drejtoreshë e komanduar e Sektorit të Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë, dhe nga z. Muhamed Prezja, ekspert ligjor po në këtë Sektor të ASCAL.

Grupit të vlerësuesëve të jashtëm, GVJ, iu vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për vlerësimin e Programit, i depozituar në e-ASCAL nga vetë institucioni. Ky dokumentacion u shqyrtua me hollësi, veçanërisht Raporti i Vlerësimit të Brendshëm<sup>1</sup>; ky dokument ishte mbështetja kryesore, jo vetëm për të njohur gjendjen, por edhe si udhëzues për t'u thelluar më tej në njohjen e Programit, të vlerave dhe shqetësimeve. Për shkak të gjendjes Covid 19, takimet me gjithë palët e interesuara në UVl u organizuan *online* në Platformën Zoom, të menaxhuar nën kujdesin e Dr. Bixheku dhe z. Prezja. Këto u zhvilluan në 2 ditë, dt. 10 dhe 11 Mars 2021. Në ditën e parë u zhvilluan takime me Dekanin e FShTN, Përgjegjës të DB, me Grupin e vetëvlerësimit, me Personelin akademik të Programit, përfaqësues të NJSBCVI, me përfaqësues të Sekretarisë mësimore, me përfaqësues të Qendrës së Kërkimit

<sup>1</sup>Raport RVB-Departamenti i Biologjisë-Maj 2020 PDF.pdf

Shkencor të FShTN. Po në këtë ditë u mundësua vëzhgimi *online* i mjediseve (auditorëve, laboratorëve, sallave të bibliotekave, mjediseve sportive, shërbimeve për studentët etj.).

Në ditën e dytë u organizuan takime me përfaqësues të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, me përfaqësues të Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I & II, takim dhe intervista me studentë që ndjekin këtë Program, ose të programeve master në vijm, dhe në fund një takim përmbyllës me përgjegjësen e Departamentit, Dr. A. Çizmja. Gjatë gjithë takimeve u shkëmbyen mendime dhe u plotësuan më tej me informacion lidhur me Programin mësimor (Planin mësimor, lëndët dhe modulet, syllabuset etj.), me Personelin akademik (performancën, kualifikimin shkencor, motivimin), Hapësirat në dispozicion, Shkallën e kënaqësisë së studentëve, Menaxhimin e mësimdhënies (sistemin *e-learning*), Sekretarinë mësimore, Bibliotekën etj.

Më pas secili prej nesh mori gjithë kohën e duhur për përpilimin e këtij Raporti, duke e kaluar në mënyrë të ndërsjellë te njëri-tjetri për të njësuar formën dhe përmbajtjen, vlerësimin përkatës, deri të analiza SWOT në fund, dhe më pas në përcjelljen në ASCAL. Raporti përfundimtar ka pasur rishikime dhe përshtatje të ndërsjella edhe me kolegët e ASCAL.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Biologji”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti Ismail Qemali, Vlorë (UVI prej këtej), ofron programe studimi, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare, dhe që janë në zbatim të Ligjit 80/2015 <sup>2</sup> , Statutit të UVI (2019) <sup>3</sup> , dhe Planit Strategjik 2018-2024 të UVI <sup>4</sup> . UVI është akredituar nga ASCAL me Vendim 50/2020 për periudhën 27/11/2020 deri në 26/11/2025 <sup>5</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i Studimit të Ciklit të parë Bachelor në “Biologji”, është hapur me VKM 124/2010 <sup>6</sup> . Ai synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare të sanksionuara në parimet e funksionimit të UVI <sup>7</sup> . Është në përputhje me interesat kombëtare, dhe me strategjitë për zhvillimin ekonomik të vendit.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky Program i Studimit Bachelor në “Biologji” është në përputhje me misionin e arsimit të lartë <sup>8</sup> , si dhe me politikën udhëheqëse të UVI, të reflektuar në statutin e UVI (2019) <sup>9</sup> . Programi është në përputhje me kërkesat e nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve <sup>10</sup> , për njohuri dhe aftësi të përparuara në shkencat biologjike. Këto janë të sanksionuara edhe në Statutin e UVI (2019) <sup>11</sup> , Strategjinë e Zhvillimit të UVI <sup>12</sup> , në Planin e Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Biologjisë 2017-2024 <sup>13</sup> (DB prej këtej), si përgjegjës i këtij Programi, si dhe Planin Strategjik <sup>14</sup> për vetë Programin e Studimit Bachelor në Biologji.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe	Nga informacioni në dispozicion dhe nga intervistat me grupet e interesit në UVI, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ prej këtej) konstatoi

<sup>2</sup>Ligj Nr 80/2015 Neni 1, pika d

<sup>3</sup>Statuti i UVI (2019), Neni 3, pika 2b. <https://neë.univlora.edu.al/statuti/>

<sup>4</sup>Plani Strategjik 2018-2024, UVI, Vizioni f. 22, Misioni f. 24. [https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/11/plani\\_dok\\_final.pdf](https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/11/plani_dok_final.pdf)

<sup>5</sup><https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara>

<sup>6</sup>Evidenca I.1- VKM e hapjes së Programit të studimit Bachelor në “Biologji”.PDF

<sup>7</sup>Statuti UVI (2019), Neni 5, f. 8&9. <https://new.univlora.edu.al/statuti/>

<sup>8</sup>Ligj Nr 80/2015 Neni 1

<sup>9</sup>Statuti i UVI (2019), Neni 3, pika 2b. <https://new.univlora.edu.al/statuti/>

<sup>10</sup>KShK (2014): Përshkruesit e Niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFP). <http://www.akafp.gov.al/kualifikimet-profesionale/korniza-shqiptare-e-kualifikimeve/>

<sup>11</sup>Statuti i UVI (2019), Neni 6, pika 3.

<sup>12</sup>Plani Strategjik i UVI 2018-2024, Pika 2.4 Kurrikula. [https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/11/plani\\_dok\\_final.pdf](https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/11/plani_dok_final.pdf)

<sup>13</sup>Plani i Zhvillimit Strategjik i DB 2017-2024, f. 1. [https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/11/plani\\_dok\\_final.pdf](https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/11/plani_dok_final.pdf)

<sup>14</sup>Plani Strategjik 2017-2024 për Programin e Studimit Bachelor në “Biologji”, f. 5

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Website: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<p>ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>se Programi synon përgatitjen e biologëve, mësuesve të lëndës së Biologjisë dhe specialistëve të mjedisit me aftësi akademike, sjellje dhe njohuri të denja për të konkuruar me kërkesat e tregut të punës brenda Qarkut Vlorë dhe më gjerë.</p> <p>Megjithatë, duhet thënë se <b>Programi nuk është i vetëm në nivel kombëtar</b>; një Program i ngjashëm zhvillohet edhe në Universitetin e Tiranës; po ashtu Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Universiteti i Gjirokastrës “Eqerem Çabej”, Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”, dhe Universiteti Korçës “Fan S. Noli”, të gjithë zhvillojnë një diplomë paksa të ngjashme në Biologji-Kimi. Asnjë prej këtyre programeve homologe nuk është akredituar ende<sup>15</sup>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p><b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit në nivel institucional konstatohet qartë se Programi i studimit Bachelor në “Biologji”<sup>16</sup> është konceptuar në harmoni me Statutin e UVI (2019)<sup>17</sup>, Planin Strategjik të UVI 2018-2024<sup>18</sup>, me objektivat strategjike afatmesme dhe afatgjata në lidhje me hartimin e programeve të studimit, me vizionin dhe misionin e UVI, të fokusuar në dy drejtime: mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi është në përputhje me Statutin (2019)<sup>19</sup>, Rregulloren (2014)<sup>20</sup> dhe Planin Strategjik të UVI 2018-2024, vizionin dhe misionin e UVI, e zbërthyer kjo edhe në Strategjinë e Zhvillimit të DB 2017-2024<sup>21</sup>, në Rregulloren përkatëse të DB<sup>22</sup>, dhe në vetë Rregulloren e Programit<sup>23</sup> në shqyrtim.</p>

<sup>15</sup><https://ëëë.asc.al/sq/akreditimi/programe-te-akredituara>

<sup>16</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Biologji”.PDF

<sup>17</sup>Statuti i UVI (2019), Neni 3, pika 2b. <https://new.univlora.edu.al/statuti/>

<sup>18</sup>Plani Strategjik i UVI 2018-2024. Kurrikula. [https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/11/plani\\_dok\\_final.pdf](https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/11/plani_dok_final.pdf)

<sup>19</sup><https://new.univlora.edu.al/statuti/>

<sup>20</sup>[https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/2.-Rregullore-Universitetit-\\_Ismail-Qemali\\_-Vlore-Mars-20151.pdf](https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/2.-Rregullore-Universitetit-_Ismail-Qemali_-Vlore-Mars-20151.pdf)

<sup>21</sup>Evidenca I.3- Plani i Zhvillimit Strategjik i DB-së 2017-2024.PDF

<sup>22</sup>Evidenca I.2- Rregullore e Departamentit të Biologjisë.PDF

<sup>23</sup>Evidenca I.5- Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Biologji.PDF

<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e Programit <sup>24</sup> të studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të UV1, të sanksionuara këto në Statut (2019) <sup>25</sup> , Rregullore (2014) <sup>26</sup> dhe Planin Strategjik 2018-2024, por dhe në Strategjinë e Zhvillimit të DB 2017-2024 <sup>27</sup> , në Rregulloren përkatëse të DB <sup>28</sup> , dhe në vetë Rregulloren e Programit në shqyrtim.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.3

#### Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Biologji”<sup>29</sup>, si pjesë e DB, është relativisht i ri, i hapur në vitin 2010. Studentët që diplomohen në këtë Program mund të ndjekin programet e cikleve të dyta pranë DB, në Master Profesional “Mësuesi AM në Biologji me Profil Minor në Kimi”, si dhe Master Shkencor në “Biologji Mjedisore”, dhe në MSc të ngjashëm në Universitetin e Tiranës.</p> <p>Objektivat për formimin e studentëve janë evidentuar qartë, si në Program dhe në Rregulloren përkatëse<sup>30</sup>. Këto përfshijnë pajisjen e studentëve me njohuri bazë në fushën e Biologjisë, më mësimdhënie dhe kërkim, me njohuri teorike dhe praktike.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit	<p>Programi është përmbushje e drejtpërdrejtë e misionit të DB, UV1, për përgatitjen e biologëve, mësuesve të lëndës së Biologjisë dhe specialistëve të mjedisit me aftësi akademike, sjellje dhe njohuri të denja për të konkuruar me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Në Tabelën 21 të RVB (2020) dhe nga intervistat në institucion numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë në katër vitet e fundit ka qenë gjithsej 137 studentë: 63 studentë në vitin akademik 2016-2017, 25 studentë në 2017-2018, 17 studentë në 2018-2019, 12 studentë në 2019-2020 dhe 20 studentë në 2020-2021. Po sipas RVB (2020), Tabela 23, dhe nga intervista jonë në numri i të diplomuarve në katër vitet e fundit ka qenë 179 studentë gjithsej, konkretisht 55 studentë në</p>

<sup>24</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Biologji”.PDF

<sup>25</sup><https://new.univlora.edu.al/statuti/>

<sup>26</sup>[https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/2.-Rregullore-Universitetit\\_-Ismail-Qemali\\_-Vlore-Mars-20151.pdf](https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/2.-Rregullore-Universitetit_-Ismail-Qemali_-Vlore-Mars-20151.pdf)

<sup>27</sup>Evidenca I.3- Plani i Zhvillimit Strategjik i DB-së 2017-2024.PDF

<sup>28</sup>Evidenca I.2- Rregullore e Departamentit të Biologjisë.PDF

<sup>29</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Biologji”.PDF

<sup>30</sup>Evidenca I.5- Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Biologji.PDF

*Alvis*

*Alvis*



<p>të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>2016-2017, 46 studentë në 2017-2018, 58 studentë në 2018-2019, dhe 20 studentë në 2019-2020. <b>GVJ vë re rënie të dukshme të numrit të studentëve të regjistruar, deri në 3 herë.</b></p> <p>Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarave mund të gjenden në një Pyetësor të DB (2019-2020)<sup>31</sup>, edhe pse i ndërtuar jo në qartësinë e duhur. Gjithsesi, në këtë Pyetësor kanë marrë pjesë 63 studentë të diplomuar në Programin në shqyrtim dhe Progamet Master që vijojnë nga ky Program, pra vetëm rreth 40% e studentëve të diplomuar në 3 vitet e fundit; mbi 80% e të intervistuarve ndjekin mastera në vazhdim të UVl, dhe të tjerët në masterat biologjikë të ofruara nga Universiteti i Tiranës. Shumica e studentëve që përfundojnë studimet në UVl, ndjekin MP të Mësuesisë AM të Biologjisë. Rreth 70% e të intervistuarve janë të punësuar (pra rreth 28% e të gjithë diplomuarve), rreth 30% e tyre në administratën shtetërore të Qarkut të Vlorës, rreth 15% në arsim, dhe 15% si ekspertë të OJF-ve vendore.</p> <p>UVl ka bërë përpjekje të marrë pjesë në Panairin “Work and Study”<sup>32</sup>, por nuk ka mundur për mungesë fondesh. Në RVB theksohet se UVl zhvillon takime e workshope me institucione dhe subjekte në qytetin e Vlorës për të diskutuar e ndarë mendime lidhur me punësimin e të diplomuarve dhe bashkëpunime të tjera me stafin akademik, por për këto nuk ka dokumentacion mbështetës në dosje.</p> <p>Nga informacioni në dispozicion dhe nga intervistat me grupet e interesit në UVl, <b>GVJkonstaton se nuk del shumë qartë se cilika qenë studimi fillestar dhe në vijim mbi nevojën e tregut të punës për të diplomuar në këtë Program studimi</b>, si në nivel vendor dhe atë ndërkombëtar, lidhur me kërkesat e punëdhënësve për forcën e punës për një periudhë afatmesme, dhe mbi politikat kombëtare të punësimin dhe zhvillimit (U1-MASR/2020)<sup>33</sup>. Kjo lidhur në aspektin e njohjes me të dhënat zyrtarenga punëdhënësit e mundshëm që veprojnë brenda Qarkut, ose dhe më gjerë, mbi kërkesat dhe nevojat e tyre, dhe mbi mundësitë e punësimin të studentëve të diplomuar. Këtu duhet shtuar edhe nga sa pohuam më sipër (Standardi I/1, Kriteri 4) mbi praninë e disa diplomave të ngjashme në vend. <b>Po ashtu nuk janë parë prirjet e zvogëlimit të numrit të nxënësve që përfundojnë gjimnazet në vite, si brenda Qarkut Vlorë dhe në gjithë Shqipërinë</b>, si kandidatë të mundshëm edhe për të ndjekur këtë Program, e cila shoqërohet edhe më prirjet në uljen e numrit të pranimeve në këtë Program.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Biologji”, si pjesë e DB, UVl, është relativisht i ri, i hapur në vitin 2010. Studentët që diplomohen në këtë Program mund të ndjekin programet e cikleve të dyta pranë Departamentit të Biologjisë, në Master Profesional “Mësuesi AM në Biologji me Profil Minor në Kimi”, si dhe Master Shkencor në “Biologji Mjedisore”, dhe në MSc të ngjashëm në Universitetin e Tiranës.</p>

<sup>31</sup> Evidenca I.7-Raporti i rezultateve të pyetësorit për studentët e diplomuar në programet e studimit në DB.PDF

<sup>32</sup>I.8- Panairi “Work and Study”.PDF

<sup>33</sup>Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf

*Alb*

*Thim*

kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Shpërndarja e veprimtarive formuese (lëndëve) në Programin e Studimit është në përputhje me kërkesat e Shtojcës 1 dhe kërkesat e tjera të VKM 41/2018 <sup>34</sup> . Objektivat e të nxëniet për secilën veprimtari janë në funksion dhe në përputhje me objektivat e përgjithshme të Programit <sup>35</sup> , Planin mësimor <sup>36</sup> përkatës dhe përmbajtjen e Lëndëve (syllabuset) <sup>37</sup> . Ato garantojnë formimin teorik dhe praktik të specialistëve në Biologji.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi I.4

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, është themeluar në 1994 (VKM 105/1994). Themelimi u mbështet në traditën arsimore të mëparshme, konkretisht në Shkollën Tregtare (prej vitit 1919) dhe më pas në filialin e Ekonomikut (1970-1980), Universiteti i Tiranës, në Shkollën e Lartë të Marinës, si dhe në Shkollën e Mesme Mjekësore <sup>38</sup> . Pas rreth 25 vitesh UVI ka 17 departamente me mbi 10,000 studentë në të tre nivelet e studimit: 31 programe BSc, 20 programe MP, 13 programe MSc, 1, MSc (PI) dhe 1 program Dr. Deri sot janë diplomuar mbi 4000 studentë. Universiteti ka 6 fakultete, 16 departamente, 5 qendra kërkimore, dhe 22 qendra administrative. Ka rreth 210 punonjës si staf të brendshëm: 6 punonjës me titullin Profesor, 27 punonjës me titullin Profesor i Asociuar, 74 punonjës Doktorë, 2 Docente dhe 102 punonjës me diplomën Master. Për rrjedhojë UVI ka mundur të përfitojë përvojë, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e një programi studimi në bachelor në "Biologji".
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas	Njësia kryesore përgjegjëse për Programin e studimit është Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore (FShTN), i përbërë nga departamentet e Biologjisë, Fizikës, Kimisë, Matematikës, Inxhinierisë dhe Teknologjisë Detare, Shkencave Detare, Shkencave Kompjuterike, dhe një Qendër Kërkimore Shkencore, e fokusuar në studime mjedisore (prej vitit 2008).  Për vitin 2019-2020 stafi akademik i brendshëm i FShTN ka 67 punonjës, 12 punonjës ndihmës, dhe 6 punonjës me kontratë (pedagogë të jashtëm) (Tabela 1.1 në RVB, 2020) <sup>39</sup> . Prej tyre 1 ka titullin "Profesor", 8 janë me titull "Profesor i asociuar", 28 me gradën

<sup>34</sup>VKM 41/2018, Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë

<sup>35</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>36</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>37</sup>Evidenca II.1- Syllabuset lëndore.PDF

<sup>38</sup><https://univlora.edu.al/historiku-i-universitetit-ismail-qemali-vlore/>

<sup>39</sup>Raport RVB-Departamenti i Biologjise-Maj 2020 PDF.pdf



direktive dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>“Doktor” dhe 30 me diplomën Master Shkencor, 7 prej tyre në proces doktorimi. Me këta mbulohen veprimtaritë formuese në 11 Programe BSc, 3 Programe MSc, 7 Programe MP, dhe 1 Program Dr (Tabela 3 në RVB, 2020).</p> <p>Në shumicën e dokumentave emërtimi i njësisë kryesore është Fakulteti i Shkencave Teknike, i cili ka ndryshuar në Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, pas miratimit të Statutit (2019)<sup>40</sup> të UVL nga MASR. Kjo bën që Programi të jetë në përputhje me fushën akademike të kësaj njësie. <b>Këshillojmë që emërtimi FShTN të përdoret edhe në gjithë dokumentat e nevojshme të DB dhe të Programit në vijim.</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktive dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Njësisia bazë përgjegjëse për Programin e studimit është Departamenti i Biologjisë (DB) pranë FShTN, i themeluar në 2010<sup>41</sup>, ku përfshihet vetëm 1 grup MK në Biologji Mjedisore. DB ka në dispozicion për mësimdhënien e Programit 5 laboratorë (Botanikë, Zoologji, Mikrobiologji, Qendra Kërkimore Shkencore, Kimi dhe Informatikë). Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit bachelor në “Biologji” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DB, si përgjegjës për këtë Program, në harmoni me klasifikimi/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktive dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. DB synon në përgatitjen e biologëve, mësuesve të biologjisë dhe specialistëve të mjedisit e turizmit me aftësi akademike, sjellje dhe njohuri të denja për të konkuruar me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes</p>	<p>Këto marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit rregullohen përmes Statutit<sup>42</sup> dhe Rregullores së UVl, dhe janë në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Në varësi të Rektorit dhe Administratorit të UVl janë dhe strukturat ndihmës-akademike administrative që mbështetin mbarëvajtjen e Programit. Në UVl funksionon Zyra e Karrierës së Studentëve, në shërbim të informimit dhe orientimit të</p>

<sup>40</sup><https://new.univlora.edu.al/statuti/>

<sup>41</sup>Evidenca II.6- Vendim Senati Nr. prot. 22 datë 10 .07.2010.PDF

<sup>42</sup>Evidenca A - Statuti i UV-së

<p>së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>studentëve apo çdo personi tjetër të interesuar për veprimtarinë e FSHTN.</p> <p>Dekanati i FSHTN bashkërendon oraret mësimore, ngarkesën e pedagogëve, komunikimin midis njësisive të FSHTN për lëndët e programit të studimit që ofrohen nga departamenteve të tjera si: Fizikë, Matematikë, Gjuhë e Huaj, TIK<sup>43</sup>. Dekanati miraton paraprakisht propozimet e DB për hapjen apo riorganizimin e programeve të studimit, kuotat<sup>44</sup>, kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit dhe çdo propozim tjetër dhe i përcjell ato në Senatin Akademik për miratim përfundimtar.</p> <p>DB, si njësi bazë përgjegjëse për Programin e Studimit Bachelor në “Biologji”<sup>45</sup>, bashkërendon punën me njësi të tjera brenda FSHTN si dhe me fakultete të tjera brenda njësisë qëndrore. DB bashkëpunon me departamentet, të cilët mbulojnë disiplinat e formimit të përgjithshëm për përmbushjen e nevojave të Programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Sipas RVB, Strategjisë së ndërkombëtarizimit<sup>46</sup> dhe intervistave vihet re se UVI, përgjatë veprimtarisë 25 vjeçare, ka deri 70 bashkëpunime me Universitete të vendeve të rajonit, Evropiane, ShBA etj., një pjesë e tyre shtrihen deri në 2023. Këto përfshijnë kryesisht kualifikime të stafit dhe studentëve, bashkëpunime në kërkim dhe shkëmbim përvoje.</p> <p>Po ashtu ka shumë Marrëveshje dypalëshe<sup>47</sup> mirëkuptimi mes institucioneve universitare në Europë dhe më gjerë, të cilat lehtësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare, zhvillimin e programeve të përbashkëta studimi, kërkime të përbashkëta etj. UVI është anëtar i disa Rrjeteve universitare<sup>48</sup>.</p> <p>UVI ka marrë pjesë në disa Projekte ndërkombëtare<sup>49</sup> të BE dhe të tjerë donatorë, si IPA, ERASMUS+, Interreg, Macro – Adriatico Ionico, Med Balkan, Horizont 2020, Europe for Citizens, COSME, TEMPUS, MEVLANA etj.</p> <p>Gjithë këto marrëveshje bashkëpunimi dhe projekte kanë ndihmuar edhe në kualifikimin e stafit akademik të DB dhe studentëve të Programit, në doktorime të stafit, në kërkime të përbashkëta, dhe fuqizim të laboratorëve dhe bibliotekës.</p> <p>Si pjesë e FSHTN, DB ka nënshkruar disa Marrëveshje bashkëpunimi<sup>50</sup> me institucione publike e jopublike brenda Qarkut të Vlorës dhe më gjerë. Këto marrëveshje kanë për qëllim mundësimin e praktikave, bashkëpunimin shkencor, shkëmbim përvoje, si dhe si partnerë në projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>

<sup>43</sup>Evidenca I.13 - Komunikimi i dekanatit për lëndët ndër fakultetore.

<sup>44</sup>Evidenca I.15 - Procedurë miratimi kuotash në DB

<sup>45</sup>Evidenca I.6 - Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Biologji”

<sup>46</sup>Evidenca D- Strategjia e Ndërkombëtarizimit.pdf

<sup>47</sup><https://univlora.edu.al/ sektori-projekteve/mou-jashte-shqiperise/>

<sup>48</sup><https://univlora.edu.al/ sektori-projekteve/rrjete-nderkombetare/>

<sup>49</sup><https://univlora.edu.al/ sektori-projekteve/lista-e-projekteve/>

<sup>50</sup>Evidenca I.22- Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera.pdf

<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>DB harton Raporte<sup>51</sup> vjetore për punën mësimore dhe kërkimore në të cilën merren në analizë edhe përfitimet nga bashkëpunimet e ndryshme. Kjo në formën e arritjeve në procesin mësimor dhe atë kërkimor (punë diplome, doktorime, publikime dhe pjesëmarrje në konferenca etj.).</p> <p><b>Mendojmë se Raportet mund të strukturohen më mirë, sidomos me arritjet në kërkim,</b> për të shmangur përsëritje në tituj publikimesh, apo pjesëmarrje në ngjarje të ndryshme kërkimore. Por ajo që është më e rëndësishme për të bërë dallimin mes stafit mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, dhe arritjet nga njëri vit në tjetrin, janë <b>përdorimi i treguesve më të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Mbi bazën e tyre, institucioni mund të bëjë edhe promovime nxitëse për arritjet më të mira.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Si pjesë e FSHTN, DB ka nënshkruar disa Marrëveshje bashkëpunimi<sup>52</sup> me institucione publike e jopublike brenda Qarkut të Vlorës dhe më gjerë, si ARZM, DRShP, Vlorë etj. Këto marrëveshje kanë për qëllim mundësimin e praktikave, bashkëpunim për punë diplome etj.</p> <p><b>Mendojmë se në Vlorë ka më shumë mundësi për bashkëpunime lidhur me mbarëvajtjen e Programit</b> dhe të Masterave që rrjedhin prej tij, si DAR, DRM, QTTB, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Ministria e Bujqësisë, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit etj.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>UVI nëpërmjet Qendrës Studimore Ndërdisciplinore të Zhvillimit Rajonal (RDC)<sup>53</sup> gjatë vitit 2019 ka organizuar takime me karakter informues, shkëmbim përvoja dhe kualifikim mësuesish<sup>54</sup>. DB pohon se është duke hartuar module për trajnimin e mësuesve dhe është në pritje të akreditimit të tyre.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


### Standardi II.1

<sup>51</sup>Evidenca I.19- Raporti vjetor i punës mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore në DB, Janar 2018-Shtator 2019.PDF

<sup>52</sup>Evidenca I.22- Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera.pdf

<sup>53</sup><https://sites.google.com/univlora.edu.al/rdcunivloraedual/home>

<sup>54</sup>Evidenca I.24- Raport aktivitetesh i Qendrës së Zhvillimit Rajonal, Nr 78, Prot, datë 14.01.2020.PDF

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqidhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit organizohet në lëndë e module, ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS<sup>55</sup>, në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM, 41/2018<sup>56</sup>; VKM 879/2019<sup>57</sup>; U1-MASR/2020)<sup>58</sup>. Ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh, i organizuar në 2 semestra për vit, gjithsej 4 lëndë për çdo semestër, rreth 60 kredite në secilin vit, dhe në total 180 kredite. Programi mbyllet me veprimtarinë ‘Tezë diplome’ (BIO 398)<sup>59</sup>, me 6 kredite. Kjo veprimtari përmbyllëse është me Punë diplome vetëm për kandidatë të zgjedhur me mesatare note mbi 8 gjatë 2 viteve të para bachelor, kurse studentët e tjerë i nënshtrohen ‘Provimit të përgjithshëm përfundimtar’. <b>Kjo nuk del mirë qartë as në Planin mësimor, dhe as në Programet lëndore</b><sup>60</sup>. Programi është i pajisur edhe me Supplementin e diplomës<sup>61</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi ofron njohuri dhe kompetenca bazë në shkencat biologjike (Botanikë, Zoologji, Mikrobiologji, Fiziologji, Gjenetikë, Biokimi, Biologji Molekulare etj.), të domosdoshme për vijimin e studimeve të ciklit II; është i harmonizuar mjaft mirë me të dyja programet e masterit të ciklit të dytë të DB, MP Mësuesi e Biologjisë për AML, dhe MSc. Biologji Mjedisi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Njohuritë e përparuara në fushën studimit ose të punësimit, përfshirë dhe të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushave biologjike, varen nga cilësia e Planit mësimor, dhe Programeve lëndore përkatëse, nga Mjediset e duhura (auditore, laboratore), nga cilësia e Praktikave në terren, nga Literatura përkatëse në përdorim dhe Biblioteka, nga cilësia e Stafit mësimor, dhe mbi të gjitha nga cilësia e kandidatëve që pranohen për të ndjekur këtë Program. <b>GVJ mendon se në tërësinë e tyre këto përmbushen, edhe pse ka nevojë për më shumë, lidhur me rregullimin e ngarkesës, të numrit të lëndëve, të cilësisë së titullarëve të lëndëve (shih komentet në Standardin II.5, Kriteri 2), vlerësimin e cilësisë së stafit dhe motivimin e më të mirëve (shih komentet në Standardin I.5, Kriteri 3), si dhe me përpjekjet e vazhdueshme për të mundur pranime sa më cilësore në vitin e parë. Vlen të përmendim se numri i studentëve të pranuar në katër vitet e fundi ka pësuar rënie të dukshme, nga 61 studentë në v.a. 2016-2017 në 10 studentë në v.a. 2019-2020; mesatarja e notës së tyre pëson një farë rritje nga 7.15 në 2016-2017, në 8.28 në 2019-2020 (RVB, 2019; Tabela 21)<sup>62</sup>.</b></p>

<sup>55</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Biologji”.PDF

<sup>56</sup>VKM-nr.-112-date-23.2.2018-ok

<sup>57</sup>VKM Nr.879, date 18.12.2019

<sup>58</sup>Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf

<sup>59</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Biologji”.PDF

<sup>60</sup>Evidenca II.1- Syllabuset lëndore.PDF

<sup>61</sup>Evidenca II.3- Supplementi i Diplomës Bachelor në “Biologji”.PDF

<sup>62</sup>Raport RVB-Departamenti i Biologjisë-Maj 2020 PDF.pdf

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Edhe përmbushja e këtij Kriteri lidhet me shumë faktorë të përmendur më sipër (Kriteri 3), ku veçanërisht ndikojnë cilësia e Laboratorëve, cilësia Stafit mësimor, por dhe cilësia e kandidatëve që pranohen. Nga cilësia e stafit do të theksonim shumë përvojën në projekte mësimore-kërkimore, në grupe pune për kërkime me karakter praktik në fushën e biologjisë së ruajtjes, dhe të edukimit biologjik, dhe sidomos nga treguesit konkretë mbi arritjet që ka patur secili në karrierën profesionale. DB ka në dispozicion për mësimdhënien e Programit 5 laboratorë (Botanikë, Zoologji, Mikrobiologji, Qendra Kërkimore Shkencore, Kimi dhe Informatikë)<sup>63</sup>. Në Standardin I.5, Kriterin 2, përmendëm se UVI ka marrë pjesë në disa Projekte ndërkombëtare<sup>64</sup> të BE dhe të tjerë donatorë, ku janë angazhuar edhe anëtarë të stafit të DB. Kjo mund të vihet re edhe nga syllabuset përkatëse të secilit<sup>65</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit rezulton se ky program studimi, përsa i përket strukturës dhe elementëve përbërës të tij, është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM, 41/2018<sup>66</sup>; VKM 879/2019<sup>67</sup>; U1-MASR/2020)<sup>68</sup>.</p> <p>Gjithashtu, programi është saktësisht i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas elementëve të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore, praktika etj.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese të Programit<sup>69</sup> grupojnë lëndët/modulet sipas kategorive bashkë dhe me ngarkesën përkatëse në kredite sipas kërkesave të VKM 41/2018.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

## Standardi II.2

### Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për</p>	<p>FSHTN, UVI, është njësia kryesore e strukturuar për të ofruar programe studimi, në përputhje me Ligjin 80/2015. Kjo mbështet në</p>

<sup>63</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>64</sup><https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/lista-e-projekteve/>

<sup>65</sup>Evidenca II.2- CV-të e Personelit Akademik në funksion të Programit të Studimit Bachelor në "Biologji".pdf

<sup>66</sup>VKM-nr.-112-date-23.2.2018-ok

<sup>67</sup>VKM Nr.879, date 18.12.2019

<sup>68</sup>Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf

<sup>69</sup>Evidenca I.6 - Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji"


Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dheakreditimin.</p>	<p>gjithëdokumentat e Strukturës organizative, Statutit dhe Rregullores së UVl, si edhe mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësia kryesore – fakulteti përmbush detyrimet ligjore përkatëse. DB si njësi bazë përgjegjëse për këtë Program i plotëson kriteret, si për Personelin akademik në total, ashtu edhe për kërkesat në lidhje me kualifikimin e tij, por me komentet që jepen më poshtë (në Kriterin 4). Në Kriterin I.4 kemi dhënë më shumë për organizimin e UVl dhe tëFSHTN.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit, gjithë dokumentacionit në faqen e-ASCAL, si edhe takimeve me përfaqësuesit e institucionit, rezultoi se ecuria dhe zhvillimi i Programit koordinohet nga Përgjegjësi i DB në bashkëpunim me Përgjegjësin e grupit MK<sup>70</sup> dhe Koordinatorin<sup>71</sup>. Përgjegjësi i DB informon vazhdimisht titullarin e FSHTN</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Organizimi i FSHTN në departamente, dhe i DB si pjesë e tij përmbushin detyrimet, dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015, e sanksionuar kjo në gjithë dokumentat e Strukturës organizative, Statutit dhe Rregullores së UVl. Në Kriterin I.4 kemi dhënë më shumë për organizimin e UVl, të FSHTN, dhe të DB.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>DB<sup>72</sup> në vitin 2019-2020 ka gjithsej 15 personel akademik, 10 të brendshëm (2 Prof.asoc., 5 Dr dhe 3 MSc), 2 ndihmës, dhe 3 me kontratë (1 Prof.asoc dhe 2 MSc) (Tabela 1.1, në RVB, 2020)<sup>73</sup>. Nga dokumentacioni dhe intervistat në Institucion, GVJ konstaton se DB bën përpjekje për të rritur cilësinë e stafit mësimor, edhe pse në vite ka patur disa largime drejt UT, e cila pa dyshim lë gjurmë në cilësinë e mësimdhënies. Megjithatë, <b>GVJ mendon se ka nevojë për më shumë, lidhur me rregullimin e ngarkesës, të numrit të lëndëve, të cilësisë së titullarëve të lëndëve, vlerësimin e cilësisë së stafit dhe motivimin e më të mirëve, kontratën me të punësuarit për të parandaluar rrjedhjen e trurit etj.</b> (shih komentet në Standardin I.5, Kriteri 3), etj. Por këtu mendojmë se edhe MASR mund të ndihmojë në këtë proces, pasi GVJ konstatoi se mangësitë në kualifikim (doktorim dhe tituj akademikë) janë edhe si rrjedhojë e ngrirjes dhe vonesës së akteve përkatëse për të dy proceset, në zbatim të Ligjit 80/2015.</p>

<sup>70</sup>Evidenca II.11 - Riorganizimi i grupeve mësimore në DB

<sup>71</sup>Evidenca II.12 - Emërimi i koordinatorit për marrëdhëniet me studentin për programet e studimit që mbulon DB-ja

<sup>72</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>73</sup>Raport RVB-Departamenti i Biologjise-Maj 2020 PDF.pdf



<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Rezultoni e dokumentuar qartë se FShTN dhe DB përmbushin detyrimet ligjore përsa i përket organizimit dhe strukturës akademike.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	FSHTN dhe DB disponojnë gjithë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e Programit të studimeve. Në Standardet I.4 dhe I.2 kemi dhënë më shumë për organizimin e UVI, të FShTN dhe DB. Kjo del nga shqyrtimi i RVB (2019) <sup>74</sup> , gjithë dokumentacionit në faqen e-ASCAL, si edhe takimeve me përfaqësuesit e institucionit ( <i>shih</i> dhe Standardin II.2, Kriterin 1).
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi <sup>75</sup> i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi (VKM, 41/2018 <sup>76</sup> ; VKM 879/2019 <sup>77</sup> ; U1-MASR/2020) <sup>78</sup> ( <i>shih</i> dhe Standardin II.1, Kriterin 1).
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi <sup>79</sup> i studimit organizohet në lëndë e module, ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit evropian ECTS, në përputhje dhe me legjislacionin vendas (VKM, 41/2018 <sup>80</sup> ; VKM 879/2019 <sup>81</sup> ; U1-MASR/2020) <sup>82</sup> . Ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh, i organizuar në 2 semestra për vit, gjithsej 4 lëndë për çdo semestër, rreth 60 kredite në secilin vit, dhe në total 180 kredite. Programi është i pajisur edhe me Supplementin e diplomës <sup>83</sup> ( <i>shih</i> dhe Standardin II.2, Kriterin 1).

<sup>74</sup>Raport RVB-Departamenti i Biologjise-Maj 2020 PDF.pdf

<sup>75</sup> Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>76</sup>VKM-nr.-112-date-23.2.2018-ok

<sup>77</sup>VKM Nr.879, date 18.12.2019

<sup>78</sup>Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf

<sup>79</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>80</sup>VKM-nr.-112-date-23.2.2018-ok

<sup>81</sup>VKM Nr.879, date 18.12.2019

<sup>82</sup>Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf

<sup>83</sup>Evidenca II.3- Supplementi i Diplomës Bachelor në "Biologji".PDF

*Albin*

*Armin*

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit përmban Planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. <b>Provimi i përgjithshëm përfundimtar nuk del mirë qartë në Planin mësimor dhe në Programet lëndore<sup>84</sup>.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e pranimit për v.a. 2019-2020 janë edhe në dosjen e ASCAL<sup>85</sup>. Kurse kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit janë shkruar në Rregulloren e UV1<sup>86</sup>, mbështetur në kuotat dhe kriteret e propozuara nga DB, dhe dhe të miratuara nga SA.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithëkomponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi<sup>87</sup> përmban informacionet e nevojshme për Programet lëndore (syllabuset e detajuara)<sup>88</sup>, për labororet, ushtrimet, seminarat dhe praktikat, si dhe të gjithë komponentët formues brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara (VKM, 41/2018 (Shtojca 2)<sup>89</sup>; VKM 879/2019<sup>90</sup>; U1-MASR/2020)<sup>91</sup> (Shih dhe Standardin I.1, Kriteret 5 &amp; 6).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga RVB (2019)<sup>92</sup> dhe nga intervistat në DB konstatuam se në fillim të vitit akademik, titullarët e lëndëve rishohin dhe dorëzojnë Syllabuset lëndore<sup>93</sup> të firmosuar në sekretarinë mësimore të DB, të cilat miratohen nga Dekani i FShTN. Programi lëndor i jepet studentëve para fillimit të lëndës, me gjithë sqarimet e duhura mbi zhvillimin e lëndës, ndjekjen, detyrat, vlerësimin gjatë vitit dhe në fund. Në RVB (2019) pohohet që Programet lëndore janë të ngarkuara në formë elektronike në faqen UV<sup>94</sup>, por ne nuk mund t'i shohim. Do këshillojmë që <b>Programi i studimit<sup>95</sup>, ashtu si ne e shohim në dosjen ASCAL, dhe Syllabuset lëndore të jenë të dukshme në faqen e UV1.</b> Kjo do ndihmonte kandidatët që duan të aplikojnë për të ndjekur studimet në këtë Program të njihen më</p>

<sup>84</sup>Evidenca II.1- Syllabuset lëndore.PDF

<sup>85</sup>Evidenca I.16- Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e Studimit Bachelor në Biologji.PDF

<sup>86</sup>Evidenca C - Rregulloren e UV-së e ndryshuar, Kreu V, Neni 39

<sup>87</sup>Evidenca I.6 - Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji"

<sup>88</sup>Evidenca II.1- Syllabuset lëndore.PDF

<sup>89</sup>VKM-nr.-112-date-23.2.2018-ok

<sup>90</sup>VKM Nr.879, date 18.12.2019

<sup>91</sup>Udhëzimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf

<sup>92</sup>Raport RVB-Departamenti i Biologjise-Maj 2020 PDF.pdf

<sup>93</sup>Evidenca II.1- Syllabuset lëndore.PDF

<sup>94</sup><https://univlora.edu.al/programet-e-studimit-biologji/>

<sup>95</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF



Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Website: www.ascal.al

	shumë me Planin mësimor dhe me përmbajtjen e lëndëve përkatëse dhe me të dhëna të tjera mbi punësimin, ecurinë e mëtejshme etj. Ka rëndësi që në Syllabuse të shkruhet qartë sipas kërkesave edhe lista e literaturës bazë dhe asaj mbështetëse mbi të cilat mbështet Syllabusi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e Programit <sup>96</sup> të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi (VKM, 41/2018 <sup>97</sup> ; VKM 879/2019 <sup>98</sup> ; U1-MASR/2020) <sup>99</sup> (shih dhe Standardin II.3, Kriteret 2 & 3). Ato janë në përputhje me Nivelin 6, dhe Përshkruesin përkatës të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) <sup>100</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikavemundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi i diplomës së Programit <sup>101</sup> dhe përmbajtja e lëndëve dhe shpërndarja veprimtarive brenda tyre (laboratore, praktika etj.) mundësojnë njohuri bashkëkohore dhe atraktive për studentët. Ato janë të organizuara sipas objektivave të formimit dhe mundësojnë marrjen e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme në masterat biologjikë, si dhe punësim.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të Programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional në shkencat biologjike (Shih dhe Standardin I.1, Kriteret 5 & 6, si dhe Standardin II.3, Kriteret 2 deri 6).

<sup>96</sup> Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>97</sup>VKM-nr.-112-date-23.2.2018-ok

<sup>98</sup>VKM Nr.879, date 18.12.2019

<sup>99</sup>Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf

<sup>100</sup><http://www.akafp.gov.al/kualifikimet-profesionale/korniza-shqiptare-e-kualifikimeve/>

<sup>101</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e Programit<sup>102</sup>, Lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor.</p> <p>Programi është relativisht i përafërt me programe të ngjashme në vend (p.sh. me atë të Universitetit të Tiranës), dhe relativisht i ngjashëm me programe homologe ndërkombëtare. Sjellim këtu sa për krahasim2 gruplëndët kryesore të Programit: Botanikë e Përgjithshme + Botanikë Sistematike (9+8=17 Kredite), dhe Zoologji invertebrore + Zoologji vertebrore + Anatomi e Krahasuar (8+8+6=22 Kredite), ose 39 Kredite gjithsej në UVl; në UT:<sup>103</sup> Botanikë e Përgjithshme + Botanikë Sistematike (9+8=17 Kredite), dhe Zoologji invertebrore + Zoologji vertebrore + Anatomi e Krahasuar (8+5+4=17 Kredite), ose 34 Kredite gjithsej; kurse në Universitetin e Romës 'La Sapienza'<sup>104</sup> në Programin Biologji, profili i Përgjithshëm (Biologia, Generale) ka vetëm Botanikë dhe sistematikë bimore (9 Kredite) dhe Zoologji + Zoologji e Krahasuar (9+6=15 Kredite), 24 Kredite gjithsej. Kjo ngarkesë e madhe në lëndët Botanikë dhe Zoologji ndikon në ngarkesën e lëndëve të tjera, në shpërndarjen ekuilibruar të njohurive, në përputhje dhe me kërkesat e kohës. <b>Mendojmë se DB duhet të synojë në përshtatjen sa më mirë të Programit me programe homologe me përvojë në vende të BE.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve (Shih dhe Standardin I.1, Kriteret 5 &amp; 6, si dhe Standardin II.3, Kriteret 2 deri 6). <b>Transferimi i studimeve dhe mobiliteti është më i plotë në Programet homologe brenda vendit, kurse mund të kërkojë plotësime në programet homologe të IAL-ve jashtë vendit, për komentet e mësipërme (Kriteri 4).</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në Standardin II.3, Kriteri 7, pohuam se në fillim të vitit akademik, titullarët e lëndëve rishohin dhe dorëzojnë Syllabuset lëndore<sup>105</sup> të firmosuar në sekretarinë mësimore të DB. Megjithatë, nga Syllabuset në Dosjen ASCAL, <b>në disa syllabuse literatura nuk jepet e shkruar saktë, sipas standardeve të shkrimit të literaturës, ku nuk del viti dhe shtëpia botuese e botimit, qoftë për tekstet bazë, dhe ato ndihmëse; për të tjera syllabuse, kur kjo jepet në të shumtën e rasteve literaturae detyruar dhe ndihmëse nuk është e 5 viteve të fundit.</b> Në RVB (2019) për këtë Kriter pohohet se DB është duke punuar që literatura të rekomandohet nga tekstet e disponueshme për studentët në platformën online ulibrary.rash.al, por Grupi ynë vuri re se kjo ende nuk është shfrytëzuar. <b>Këshillojmë DB të rishohë të gjithë Syllabuset, mundësisht përditësimin e tyre me literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit, dhe shkrimin e saktë të literaturës.</b></p>

<sup>102</sup> Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>103</sup> <https://sites.google.com/a/fshn.edu.al/departamenti-i-biologjisee/studime-te-nivelit-te-pare/biologji>

<sup>104</sup> <https://corsidilaurea.uniroma1.it/it/corso/2018/30043/cds>

<sup>105</sup> Evidenca II.1- Syllabuset lëndore.PDF

<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Përmbajtja e Programit garanton përfitim të dijeve në shkencat biologjike, të aftësive dhe kompetencave të synuara, me mangësitë që vijnë nga përmbajtja komentet e mësipërme për Programin në përgjithësi (Kriteri 4) dhe përditësimi i përmbajtjes së syllabueseve (Kriteri 6).			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e Programit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e të diplomuarve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Kjo është më shumë mundshme brenda vendit, po që se kemi parasysh komentet dhe këshillat e dhëna më sipër (Kriteret 4-6).			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Për këtë Kriter në RVB (2019) theksohet për një Workshop të organizuar në 2019 me temë “Studentët dhe tregu i punës” <sup>106</sup> , por nuk jepen të dhëna bindëse se sa kjo ka ndikuar në përmirësimin e Programit të studimit. Si theksojmë edhe në Standardin I.3, Kriteri 2, <b>DB duhet të bëjë më shumë përpjekje për të njohur jo vetëm nevojën e tregut të punës për të diplomuar në këtë Program studimi, si në nivel vendor dhe më gjerë, por edhe për propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës në funksion të përmirësimit të Programit dhe përshtatjen metregun.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	


<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	DB në vitin 2019-2020 ka gjithsej 15 personel akademik, 10 të brendshëm (2 Prof.asoc., 5 Dr dhe 3 MSc), 2 ndihmës, dhe 3 me kontratë (1 Prof.asoc dhe 2 MSc) (Tabela 1.1, në RVB, 2020). Numri i punonjësve akademikë pa titull dhe gradë në tre vitet e fundit është përgjithësisht mbi 30%, dhe numri i punonjësve me kontratë luhatet nga 30% e stafit të brendshëm (2019-2020) në mbi 60% (2016-2017) (kjo e fundit relativisht e lartë).  Nga dokumentacioni dhe intervistimi, RVJ mendon se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesme, që angazhohen në

<sup>106</sup>Evidenca II.29 - Workshop-i me temë “Studentët dhe tregu i punës”:

<https://univlora.edu.al/2019/12/22/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/>

	<p>realizimin e Programit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Megjithatë ne mendojmë se këtu ka shumë për përmirësim, dhe konkretisht:</p> <p><b>GVJ konstatoi mangësi në kualifikim (doktorim dhe tituj akademikë) lidhur me zhvillimin e lëndëve kryesore të Programit.</b> Këto janë rrjedhojë edhe e ngrirjes nga MASR dhe vonesës së akteve përkatëse për të dy proceset, në zbatim të Ligjit 80/2015. Disa prej të rinjve të punësuar kanë mundur të gjejnë rrugë doktorimi jashtë; të tjerë janë larguar drejt UT. <b>Në vite ka patur disa largime të personelit të ri (në ndonjë rast edhe të kualifikuar) drejt UT.</b> Kjo pa dyshim lë gjurmë në cilësinë e mësimdhënies. Këtu sërish rithekojmë se <b>UVI të bëjë përpjekje për të siguruar kushtet dhe për të gjetur rrugët e duhura ligjore për të parandaluar rrjedhjen e trurit</b>(shih komentet në Standardin I.5, Kriteri 3), etj. Këshillojmë që ASCAL ta përcjellë çështjen e doktorimit në vend edhe në rrugë zyrtare drejt MASR.</p> <p>Për shumë anëtarë numri i lëndëve shkon nga 5 deri në 7 lëndë brenda Programit dhe në Programe të tjeranë FSHTN (nga 2-3 lëndë që është norma sipas U29). <b>GVJ mendon se ngarkesa e relativisht e lartënga i njëjti titullar dhe e shpërndarë në disa lëndëtë rëndësishme, ndonjëherë edhe të fushave jo shumë të afërta nuk është në të mirën e cilësisë së mësimdhënies.</b> Për më tepër, disa lëndë të rëndësishme karakterizuese mbulohen nga personel pa gradë shkencore. <b>Këshillojmë DB që titullarët e lëndëve karakterizuese të mbulohen të paktën nga personel me gradë shkencore.</b>Të rishihet numri i lëndëve dhe i ngarkesës së personelit në përputhje me U29/MASR (2018). <b>Të shmangët zhvillimi nga i njëjti personel efektiv i lëndëve me përmbajtje nga fusha shkencore jo të afërta</b> (shih dhe komentet në Kriterin3).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Rithekojmë se DB në vitin 2019-2020 ka gjithsej 15 personel akademik, 10 të brendshëm (2 Prof.asoc., 5 Dr dhe 3 MSc), 2 ndihmës, dhe 3 me kontratë (1 Prof.asoc dhe 2 MSc) (Tabela 1.1, në RVB, 2020). Numri i punonjësve akademikë pa titull dhe gradë në tre vitet e fundit është përgjithësisht mbi 30%, dhe numri i punonjësve me kontratë luhatet nga 30% e stafit të brendshëm (2019-2020) në mbi 60% (2016-2017) (kjo e fundit relativisht e lartë).</p> <p>Pjesa më e madhe e lëndëve në Program mbulohen nga stafi i DB dhe i departamenteve të FSHTN (Tabela 12.2, në RVB, 2020). Nga shqyrtimi i ngarkesës së personelit akademik të programit Bachelor në Biologji në një v.a. 2019-2020 (RVB, 2019, Tabela 4) konstatohet se si <b>numri i lëndëve dhe ngarkesa e vjetore e personelit kryesor efektiv është e lartë, krahasuar me Udhëzimin 29 të MASR (2018)<sup>107</sup>, shpesh 1.5 herë – 2.5 herë e lartë, deri në 405 orë (nga 140-195 orë që është norma sipas U29).</b> DB duhet të bëjë përpjekje ta shmangë një gjë të tillë, për të mirën e cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve konstatohet se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, janë relativisht në përputhje me Programin,</p>

<sup>107</sup>Udhezimi-nr.-29-dt-10.9.2018.pdf

specifike e anëtarëve të personelit akademik qëmbulonprogramin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	natyrën dhe veçoritë e moduleve të tij. Por ne mendojmë se këtu ka për të përmirësuar lidhur me ngarkesën mësimore, numrin e lëndëve dhe veçoritë e tyre, dhe kualifikimin e stafit që mbulojnë lëndëve karakterizuese, krahasuar edhe me U29 të MASR (2018) <sup>108</sup> , dhe shkallën e kualifikimit në për gjithësi të stafit për të cilën kemi folur nëedhe më sipër.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin ediplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Nga RVB (2019), nga Programi dhe intervistat konstatohet se DB vë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikat në terren (botanikë, zoologji), dhe në punën e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. <b>Këtu do të këshillojmë të shihet mundësia që edhe lëndë të tilla si: Ekologji, Paleontologji &amp; Bazat e Gjeologjisë/Fitogjeografi, Hidrobiologji të mund të kenë të paktën disa ditë praktikë në terren (Tab. 10, RVB, 2019).</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen elaboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	DB <sup>109</sup> në vitin 2019-2020 ka gjithsej 2 punonjës ndihmës (Tabela 1.1, në RVB, 2020) <sup>110</sup> dhe 4 laboratorë (Botanikë, Zoologji, Mikrobiologji, Qendra Kërkimore Shkencore) <sup>111</sup> . <b>Ndoshta më shumë personel ndihmës mund të nevojiten për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<sup>108</sup>Udhezimi-nr.-29-dt-10.9.2018.pdf

<sup>109</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

<sup>110</sup>Raport RVB-Departamenti i Biologjisë-Maj 2020 PDF.pdf

<sup>111</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".PDF

*Alsh*

*Armin*

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Rektorati dhe Senati Akademik i UVI kanë hartuar dhe miratuar Udhëzuesin në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve<sup>112</sup> dhe Strategjinë e Integritit dhe Trajnimit të Stafit të UVI<sup>113</sup>. Bazuar në to dhe përmes Planit Strategjik 2018-2024<sup>114</sup>, UVI synon që të krijojë një sërë vlerash institucionale, të cilat ndihmojnë të pasurojnë infrastrukturën akademike dhe atë institucionale në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kërkimit shkencor. Kjo ndihmon në përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve, si platformat online, lojrat interaktive, realiteti virtual dhe labororet virtual, të cilat prej disa vitesh kanë filluar të aplikohen në Programin në shqyrtim.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin evazhdueshëm të standardeve të cilësisë, në UVI është ngritur Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI)<sup>115</sup>. Kjo Njësi përpilon raportin e analizës vjetore të pyetësorëve sipas “Procedurës së analizës së pyetësorëve”<sup>116</sup>, i cili është pjesë integrale e raportit vjetor<sup>117</sup> të veprimtarisë së UVI dhe ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira. Raporti në fjalë, është hartuar prej dy vitesh, 2017-2018<sup>118</sup> dhe 2018-2019<sup>119</sup>. <b>Duhet thënë se këta dy Raporte mund të strukturohen më mirë, duke filluar nga përmbajtja dhe formatimi, duke evidentuar më qartë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira, për secilën Njësi kryesore, dhe Njësi bazë përkatëse.</b> Kjo do të ndihmonte realisht dhe konkretisht njësinë bazë dhe personelin akademik përkatës në gjithë procesin e përmirësimit të programit të studimit, dhe përpilimin e planit të masave përkatëse.</p>

<sup>112</sup>Evidenca N - Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve

<sup>113</sup> Evidenca III.1 - Vendim SA, Nr.41, datë 29.01.2020, Strategjia e Integritit dhe Trajnimit të stafit të UV-së: <https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Nr.-41-Dt.-29.01.2020.pdf>

<sup>114</sup>Evidenca B - Plani Strategjik i UV-së 2018-2024, f. 6

<sup>115</sup> Evidenca III.2A - Vendimet e SA-së të UV-së: Nr. 54, datë 20.04.2017; Evidenca III.2B – Vendim SA, Nr. 28 datë 22.05.2018; Evidenca III.2C - Vendim SA, Nr. 84 datë 12.12.2016

<sup>116</sup>Evidenca III.3 - Vendim SA, Nr. 21, datë 08.05.2018, Procedurë e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies

<sup>117</sup>Evidenca J - Raporti vjetor i UV-së 2018-2019.

<sup>118</sup>Evidenca K - Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018.

<sup>119</sup>Evidenca L - Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019.



	Raporti vjetor i performancës së stafit akademik dhe ndihmës/ akademik i hartuar nga DB për vitin 2017 është ngarkuar në Platformën ASCAL i pjesëm (2 faqe nga 4 faqe) <sup>120</sup> , ku dëshmohet vlerësimi vetëm për mësimdhënien me cilësinë maksimale ‘Përtej Pritshmërive’. <b>Mendojmë se vlerësimet tilla duken jo shumë afër realitetit, po qe se kemi parasysh një sërë komentesh të dhëna më sipër, dhe nuk nxitin stafin për përmirësime të mëtejshme.</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Statuti i UVI, Rregullorja e UVI dhe Rregullorja e Programit të Studimit sigurojnë përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.  Në Dosje është një Raport analize e DB një Pyetësori <sup>121</sup> me studentët për vitin 2018-2019, për gjithë stafin akademik dhe lëndët përkatëse të Programit. Pjesëmarrja e studentëve në Pyetësor është përgjithësisht e lartë, nga 80 deri 100%, dhe vlerësimi i tyre për shumicën e pyetjeve është ‘Shumë e mirë’ dhe ‘Mirë’. Në analizë jepen rekomandime për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në drejtim të lehtësisë të procesit të mësimdhënies, të rishikimit të literaturës, përshtatjen e teknikave të mësimdhënies, duke vendosur studentin në qendër dhe pjesëmarrjen aktive të tyre, plotësimin më mirë të auditorëve me bazën materiale dhe didaktike të nevojshme më bashkëkohore, etj.
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësisia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional të UVI publikon në mënyrë periodike Raportin <sup>122</sup> e analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, së bashku me rekomandimet përkatëse. <b>Por nuk mundëm të gjejmë në faqe Raportin e Performancës së stafit akademik, ose Raportet e Analizës së Punës Vjetore,<sup>123</sup> të cilët gjenden në Dosjen ASCAL.</b>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	<b>Si në Raportin e Performancës së stafi akademik, ose në Raportet e Analizës së Punës Vjetore nuk dokumentohet se në ç’mënyrë institucioni promovon shembujt më të mirë.</b> Por në RVB sjell si shembull vlerësimet e posaçme me rastin e 25-vjetorit të themelimit të UVI, ku janë dhënë disa Çertifikata Nderi apo Mirënjohje, por asnjë për personelin akademik të DB, madje të bën përshtypje që një pjesë e mirë e kandidatëve të ndëruar ishin personel akademik i jashtëm. RVB sjell si shembuj të dokumentuar të mbështetjes financiare për stafin e DB <sup>124</sup> lidhur me rimbursimin e shpenzimeve (udhëtim, fjetje etj.) për pjesëmarrje në ngjarje shkencore jashtë shtetit, apo përfshirjen në programet e mobilitetit Erasmus+ për trajnim në mësimdhënie <sup>125</sup> . GVJ

<sup>120</sup>Evidenca III.8 - Performancë stafi akademik, e plotësuar nga Drejtuesja e DB-së sipas formatit të miratuar nga SA, me Vendim Nr 52, datë. 20. 04. 2017

<sup>121</sup>Evidenca III.11- Raportit të analizës së pyetësorit të studentëve.PDF

<sup>122</sup> Evidenca III.11 - Raporti i analizës së pyetësorit të studentëve:

<https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>

<sup>123</sup> Evidenca I- Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; dhe Evidenca J- Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019.pdf

<sup>124</sup>Evidenca III.13 - Shembull rimbursimi për pedagogët e DB-së

<sup>125</sup>Evidenca II.24 - Mobilitet stafi

	mendon se kjo nuk do ishte vetëm dhe realisht mënyra e duhur e promovimit të stafit, dhe si është theksuar disa herë edhe më sipër, këshillon <b>gjetjen dhe aplikimin e mekanizmave sa më të drejtë dhe nxitës, por dhe të institucionalizuara në Udhëzuesin e performancës, apo Rregulloret përkatëse në këtë drejtim.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Thuajse të gjitha këto forma gjenden në Programin mësimor dhe Rregulloren e Programit <sup>126</sup> , si edhe reflektohen në Planin mësimor dhe në Syllabuset <sup>127</sup> lëndore të Programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Nga Raportet e Analizës së Punës Vjetore, Raporti i Performancës së stafi akademik, nga analiza e Pyetësorëve të studentëve, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët, RVJ konstaton se personeli akademik i DB respekton kërkesat e kësaj pike. Në RVB theksohet se ka përmirësim në vitet e fundit në infrastrukturë lidhur me zbatimin e metodave të reja, leksionet në PPT dhe paraqitja me projektor. Gjithashtu, janë përmirësuar dhe pasuruar punët laboratorike me materiale, reagentë dhe preparate të indeve bimore e shtazore, në cilësinë e zhvillimit të praktikave në terren etj. <sup>128</sup> Këtu ne shtojmë edhe shtimin e hapësirave fizike laboratorike në vitin e fundit, të cilësuar edhe më lart.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e	Në RVB dhe nga kontaktet tona me Institucionin mund të pohojmë se kjo mbështetje konsiston në: sigurimin e infrastrukturës së nevojshme; sigurimin e mjeteve të nevojshme didaktike-teknologjike dhe

<sup>126</sup> Evidenca I.6 - Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji"; Evidenca I.5 - Rregulloret e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu II, Neni 5,

<sup>127</sup> Evidenca II.1 - Syllabuset lëndore.PDF

<sup>128</sup> Evidenca III.17 - Infrastruktura e UV-së në funksion të Programeve të Studimit; Evidenca II.33 - Relacion për inventarin e laboratorëve në DB; Evidenca II.23 - Relacioni i punëve laboratorike në DB; Evidenca I.23 - Raportet e zhvillimit të praktikave mësimore në terren; Evidenca II.31 - Procedura e praktikës mësimore në terren në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji"

<p>kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>laboratorike; mbështetjen e transportit, dietave dhe fjetjeve të studentëve në praktikat në terren; mbështetjen për konferenca; për pjesëmarrjen në aktivitete kërkimore; pjesëmarrjen në projekte; në mobilitetet të personelit akademik dhe studentëve jashtë shtetit etj.<sup>129</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Aktualisht (2019-2020), personeli akademik i Programit<sup>130</sup> përbëhet nga 21 pedagogë efektivë dhe 3 me kontratë, si dhe 1 personel ndihmës-akademik me gradë shkencore: 3 Profesorë të Asociuar; 10 lektorë me gradën Doktor (1 lektore e doktoruar në Itali); 8 asistent-lektorë me diplomën Master të Shkencave, 3 prej të cilëve në proces doktorimi; 1 Profesor me kontratë; 2 lektorë me kontratë me diplomën Master i Shkencave.</p> <p>Mbështetur në RVB, Raportet e Analizës së Punës Vjetore, Raportin e Performancës së stafi akademik, raportet e analizës së Pyetësorëve të studentëve, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët, mund të thuhet se kërkesa e kësaj pike përmbushet. Por RVJ ka theksuar më sipër (Standardin II.5): <b>nevojën për më shumë, lidhur me rregullimin e ngarkesës mësimore vjetore; të numrit dhe cilësisë së lëndëve që zhvillohet nga secili anëtar i stafit; të cilësisë së titullarëve të lëndëve; mbulimin e lëndëve karakterizuese të Programit me titullarë me të paktën me gradë shkencore (10 anëtarë ose gati 50% e stafit janë pa gradë shkencore); shmangien e zhvillimit nga i njëjti personel efektiv i lëndëve me përmbajtje nga fusha shkencore jo të afërta; vlerësimin e cilësisë së stafit; motivimin e më të mirëve; dhe prandalimin e rrjedhjes së trurit; mundësinë e shtimit të punonjësve ndihmës etj.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Mbështetur në Raportet e Analizës së Punës Vjetore, Raportin e Performancës së stafi akademik, raportet e analizës së Pyetësorëve të studentëve, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët, mund të thuhet se kërkesa e kësaj pike përmbushet.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe</p>	<p>Mbështetur në Raportet e Analizës së Punës Vjetore, në Raportin e Performancës së stafit akademik, raportet e analizës së Pyetësorëve të</p>

<sup>129</sup> Evidenca III.18 - Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DB; Evidenca II.33 - Relacion për inventarin e laboratorëve në DB; Evidenca III.19 - Kërkesat buxhetore të DB-së; Evidenca II.31 - Procedura e praktikës mësimore në terren në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji"; Evidenca III.20 - Konferenca studentore e organizuar nga UV-ja: <https://univlora.edu.al/2017/12/12/konferenca-studentore-e-hapur-2017/>; Evidenca III.13 - Shembull rimbursimi për pedagogët e DB-së; Evidenca III.21 - Projekti AFRIMED; Evidenca II.24 - Mobilitet stafi; Evidenca II.25 - Mobilitet studentit

<sup>130</sup> Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës, Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabela 12

diskutimi, duke i bërë theqese orët e mësimit.	studentëve <sup>131</sup> , si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët, mund të thuhet se edhe kërkesa e kësaj pike përmbushet. Pavarësisht, këtu duhet theksuar se, mbështetur në rezultatet e Pyetësorit me studentët jepen rekomandime për përmirësimin e cilësisë së mësimit në drejtim të lehtësimit të procesit të mësimit, të rishikimit të literaturës, përshtatjen e teknikave të mësimit, duke vendosur studentin në qendër dhe pjesëmarrjen aktive të tyre, etj.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Po këtu duhet theksuar se, mbështetur në rezultatet e Pyetësorit me studentët është e nevojshme përmirësimi i cilësisë së mësimit në drejtim të lehtësimit të procesit të mësimit, të rishikimit të literaturës, të përshtatjes së teknikave të mësimit, duke vendosur studentin në qendër dhe pjesëmarrjen aktive të tyre, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesisë dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Sipas RVB pohohet se procesi mësimor e shkencor lidhur me Programin zhvillohet brenda mjediseve të ndërtesës C, të FShTN <sup>132</sup> , me infrastrukturë relativisht të re, e rikonstruktuar në vitin 2017, me hapësira të mjaftueshme, cilësore dhe të pastra, që mirëmbahen rregullisht nga personeli sanitar i Sektorit të Shërbimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse <sup>133</sup> . Ndërtesa C ka 5 kate, me sipërfaqe prej 3800 m <sup>2</sup> (salla leksionesh, seminaresh, laboratorë, biblioteka, etj.). Në tabelën 16 të aneksit të RVB <sup>134</sup> , paraqiten me hollësi të gjitha mjediset e FShTN në funksion të studentëve dhe të personelit. Sipërfaqet e këtyre mjediseve janë të mjaftueshme dhe të pajisura me elementët logjistikë të nevojshëm për realizimin normal të procesit mësimor.

<sup>131</sup> Raporti i analizës së pyetësorëve; <https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>; Evidenca III.5 - Kthim përgjigje i DB-së në lidhje me raportin e analizës dhe vlerësimin të pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimit për vitin akademik 2018-2019, Shkresë, Nr. 138/2 Prot., datë 04.03.2020

<sup>132</sup> Evidenca III.17 - Infrastruktura e UV-së në funksion të Programeve të Studimit

<sup>133</sup> Evidenca I.9 - Organigrama e UV-së: <https://univlora.edu.al/administrata/>; Organigrama e Fakultetit të Shkencave Teknike: <https://univlora.edu.al/struktura-e-fsht/>

<sup>134</sup> Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabela 16

*Alsho*

*Shkencor*

	RVB pohon se hapësira në dispozicion të studentit në FSHTN është 2.9 m <sup>2</sup> /student, sipas VKM418/2017, Aneksi I, Pika C <sup>135</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Në tabelën 16 të aneksit të RVB, paraqiten me detaje të gjitha mjediset e FSHTN në funksion të studentëve dhe të personelit. Sipërfaqet e këtyre mjedisëve janë të mjaftueshme dhe të pajisura me elementët logjistikë të nevojshëm për realizimin normal të procesit mësimor. Këtë ne mund ta pohojmë edhe nga ajo që mundëm të shihnim gjatë vizitave tona <i>online</i> nëpër mjediset e FSHTN.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Sipas RVB, personeli akademik si edhe studentët, përfshirë edhe ata të që ndjekin Programin, shfrytëzojnë infrastrukturën e FSHTN, ku përfshihet edhe infrastruktura IT. Këtu përfshihet: Sistemi ië Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UVi me akronimin UVMS (University of Vlora Management System); Lidhja me internetin (fiks), që ofrohet në Ndërtesën C të FSHTN. Secili anëtar i stafit të DB është i pajisur me PC, të lidhur me rrjetin e internetit; gjithë anëtarët e personelit dhe studentët janë të pajisur me adresë e-maili zyrtare (emer.mbiemer@univlora.edu.al) dhe adresa të tjera, nëpërmjet të cilave realizohet komunikimi personeli akademik/ndihmës-akademik, student dhe anasjelltas. Gjithashtu, FSHTN ka vënë në dispozicion një sallë për Bibliotekën Shkencore <sup>136</sup> , me një specialist me 4 PC dhe një videoprojektor, e cila është në dispozicion edhe të studentëve. IT pranë FSHTN mbështetet nga një specialist IT <sup>137</sup> . Një pjesë të mirë të këtyre mjedisëve ne mundëm ta shihnim gjatë vizitave tona <i>online</i> nëpër mjediset e FSHTN.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Në RVB, mbështetur në Rregulloren e UVi, pohohet se tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve që rekomandohen për pjesën teorike dhe të detyrueshme për seminarët, ushtrimet dhe punët laboratorike miratohen çdo fillim viti akademik nga DB, me propozimin e titullarëve të lëndëve dhe përcillen te Njësia Kryesore. DB u siguron studentëve literaturën e detyruar dhe ndihmëse, në formën e teksteve mësimore ose cikël leksionesh me autorë pedagogë të DB, FSHTN, UT dhe autorë të huaj ndërkombëtarë. Kjo literaturë diskutohet në DB dhe pasqyrohet në syllabuset lëndore <sup>138</sup> , dhe u vihen në dispozicion studentëve në formë fizike dhe/ose elektronike.  Gjatë vizitave tona <i>online</i> nëpër mjediset e FSHTN, ne mundëm të njiheshim edhe me fondin kryesor të Bibliotekës të librave të siguruara për stafin dhe studentët. Por këtu, RVJ rithekson atë që është theksuar në <b>Standardin II.4, Kriterin 7, se DB duhet të rishohë të</b>

<sup>135</sup>VKM, Nr. 418, datë 10.5.2017, f. 8


<sup>136</sup>Evidenca III.26- Informacion për Bibliotekën shkencore në UV.PDF

<sup>137</sup> Evidenca III.18 - Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DB; Evidenca III.23 - Komunikimi i pedagogëve me studentët nëpërmjet postës elektronike; Evidenca III.26 - Informacion për Bibliotekën Shkencore në UV; Evidenca I.9 - Organigrama e UV-së: <https://univlora.edu.al/administrata/>; Organigrama e Fakultetit të Shkencave Teknikë <https://univlora.edu.al/struktura-e-fsht/>; Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore në UV, Sektori i IT: <https://univlora.edu.al/administrata/>

<sup>138</sup> Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu V, Neni 49; Evidenca II.20 - Procedura e Miratimit të Literaturës nga DB-ja; Evidenca II.27 - Kërkesa e DB-së për blerjen e teksteve mësimore; Evidenca II.1 - Syllabuset lëndore; Evidenca III.26 - Informacion për Bibliotekën Shkencore në UV; Evidenca III.26 - Informacion për Bibliotekën Shkencore në UV

	<p><b>gjithë Syllabuset, mundësisht përditësimin e saj me literaturë bazë dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit, dhe shkrimin e saktë, sipas standardeve të shkrimit të literaturës në gjithë Syllabuset që zhvillohen në Program.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>UVI ka në dispozicion të personelit dhe studentëve 3 biblioteka me 3 salla leximi (gjithsej rreth 50-60 vende me të ulur), njëra prej të cilave ndodhet në FSHTN. Biblioteka e FSHTN është e re, dhe përmban në gjithsej 723 vëllime, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. Gjithashtu, në funksion të procesit mësimor të Programit, DB zotëron fondin e saj të teksteve mësimore, cikleve të leksioneve dhe botimeve të tjera, në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve, sidomos për punë diplomave. DB parashikon në kërkesat e saj buxhetore fonde për blerje tekstesh edhe për përditësimin e kurrikulës akademike të Programit.</p> <p>Gjatë vizitave tona <i>online</i> nëpër mjediset e FSHTN, ne mundëm të njiheshim edhe me mjediset e Bibliotekës dhe me fondin kryesor të librave të siguruara për stafin dhe studentët. Këtu ka rëndësi edhe ndjekja nga DB e shfrytëzimit të Bibliotekës, të mjediseve të saj dhe të fondit të librave, qoftë nga studentët, por edhe nga anëtarët e stafit. Kjo ka rëndësi për të parë se sa të efektshme kanë qënë hapësirat ekzistuese dhe blerjet, dhe cilat janë kërkesat për hapësira dhe për tituj librash. <b>Ka rëndësi ndjekja dhe dokumentimi nga Biblioteka, por dhe DB si ka qënë përdorimi i fondit të Bibliotekës, por dhe i sallave nga personeli dhe studentët (Standardi IV.4, Kriteri 6).</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në RVB dhe nga intervistat mund të thuhet se në funksion të personelit akademik dhe studentëve janë libraritë <i>online</i> në faqen: <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>; kjo funksionon me regjistrim paraprak dhe adresë e-mail, nga faqja e UVI; aksesi realizohet për libraritë e fushave të ngjashme ose të përafërta me Programin duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës.</p> <p>Për Bibliotekën <i>online</i> të UVI, është punuar me burimet elektronike për Shqipërinë (<i>Electronic Resources for Albania: ERA2012 Project</i>), mbështetur nga IZUM/Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor: <a href="http://www.cobis.net">www.cobis.net</a>; EIFL/Informacioni Elektronik për Biblioteka: <a href="http://www.eifl.net">www.eifl.net</a> dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë/koordinatori për projektin ERA 2012: <a href="http://www.akad.edu.al/era">www.akad.edu.al/era</a> ku studentët dhe pedagogët kishin akses në informacion me tekst të plotë, nga Ebrary Academic Complete, EBACHELORO Academic Search Premier, Emerald Management e Journal Collection, Multi-Science Journals Collection, ProQuest Central, Taylor &amp; Francis library dhe shumë më tepër<sup>139</sup>.</p> <p>Edhe këtu, mbështetur në intervistat tona me Bibliotekën dhe drejtuesit në Institucion, <b>ka rëndësi edhe ndjekja nga DB (por jo vetëm) e shfrytëzimit të Bibliotekës online, e titujve të kërkuar, qoftë nga studentët, por edhe nga anëtarët e stafit.</b> Edhe këtu, kjo</p>

<sup>139</sup> Manuali i aksesit në Bibliotekën On-line: <https://ulibrary.rash.al/manual.pdf>; Evidenca III.26 - Informacion për Bibliotekën Shkencore në UV; Evidenca III.27 - Raport i Zyrës së IT-së: Shkresa nr.112/3 Prot., datë.20.01.2020; Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabela 17

	ka rëndësi për të parë se sa të efektshme kanë qënë përpjekjet për të siguruar aksesin <i>online</i> , cilat janë kërkesat për tituj, por edhe performancën e stafit.
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Në këtë Program <sup>140</sup> , në 15 lëndë (ose 68% e lëndëve) kanë punë laboratorike, 11 lëndë prej të cilëve ofrohen nga DB, si Biologjia Qelizore, Zoologjia Invertebrore, Botanika e Përgjithshme, Histologjia, Zoologjia. Për këtë janë në funksion të këtij Programi 5 laboratorë (Botanikë, Zoologji, Mikrobiologji, Qendra Kërkimore Shkencore, Kimi dhe Informatikë); këta janë të pajisur me PC, autoklavë, termostat, centrifugë, kapa, mikroskopë, stereomikroskopë, reagentë, gjallesa të ballsamosura, mjete preparimi, mjete demonstrimi, pajisje kampionimi në terren etj. Një pjesë të mirë të këtyre mjediseve ne mundëm ta shihnim gjatë vizitave tona <i>online</i> nëpër mjediset e FShTN.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Sistemi i menaxhimit të UVl (UVMS) <sup>141</sup> bën të mundur komunikimin e personelit akademik me studentët për secilën prej lëndëve të planit mësimor të Programit të studimit. Ky sistem ka të përfshirë Platformën <i>e-learning</i> , e cila realizohet falë hapësirës personale ( <i>account</i> ) të secilit përdorues. Personeli akademik dhe këshilltari akademik nxitin studentët që të anëtarësohen në platformën <i>e-learning</i> : <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a> . Çdo student ka Portofolin e vet elektronik, në të cilin në mënyrë konfidenciale: të regjistrohet në lëndët që dëshiron të ndjekë gjatë semestrit apo në provime, të shohë arritjet e tij akademike, dhe të marrë materiale mësimore në formatin .pdf, të ngarkuar nga pedagogët e lëndës. Drejtorja e IT ka publikuar manualet e përdorimit të Sistemit për pedagogët dhe studentët. Platforma elektronike UVMS, ndër të tjera shërben edhe për të patur akses në dokumentacionin elektronik (p.sh. shkarkimi i faturave të ndryshme), i cili kryhet nëpërmjet përdorimit të hapësirës vetjake të dedikuar për secilin përdorues të UVMS ose përdorimit nga adresa elektronike personale e zyrtare ( <a href="mailto:emer.mbiemer@univlora.edu.al">emer.mbiemer@univlora.edu.al</a> ).
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Nga gjithë përvoja jonë dhe intervistat me gjithë palët në UVl, ne mund të pohojmë se përmbushja e këtyre dy kritereve është fuqizuar dhe përsosur më tej nga gjithë periudha e pandemisë Covid 19 që jemi të gjithë duke kaluar prej më shumë se një viti.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në	Në rregulloren e Programit <sup>142</sup> , studentët që kanë plotësuar kriteret (mesatare note mbi 8) mund të diplomohen duke kryer një punë

<sup>140</sup> Evidenca I.6 - Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji"; Evidenca III.17 - Infrastruktura e UV-së në funksion të Programeve të Studimit; Evidenca II.33 - Relacion për inventarin e laboratorëve në DB

<sup>141</sup> Evidenca III.28 - Manuali i përdorimit të e-learning; Evidenca III.29 - Shembull i një Llogarie UMS e një studenti: faqja kryesore, pikët e provimeve, e-learning; Evidenca III.27 - Raport i Zyrës së IT-së: Shkresa Nr.112/3 Prot., datë.20.01.2020; Evidenca III.30 - Manuali i përdorimit të UMS për pedagogët: <https://uvms.univlora.edu.al/media/MANUAL-PERDORIMI-UVMS-PEDAGOGE.pdf>; Evidenca III.31 - Manuali i përdorimit të UMS për studentët: <https://uvms.univlora.edu.al/media/MANUAL PERDORIMI UVMS.pdf>; <https://uvms.univlora.edu.al/user/login>

<sup>142</sup> Evidenca I.5 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu VIII, Neni 65; Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB; Evidenca I.22 - Marrëveshjet

përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	diplome, kurse të tjerët me provim (me gojë ose me shkrim). Studentët që diplomohen me temë ose pedagogët propozojnë temat sipas fushave përkatëse të studimit, të cilat diskutohen dhe miratohen në DB. Pedagogët udhëheqës orientojnë dhe mbështesin studentët për punën e diplomës, në laboratorët e FSHTN, ose në institucione të tjera në Vlorë. Edhe këtu mund të ritheksojmë këshillën e dhënë në Standardin II.1, Kriterin 1, që kjo mënyrë diplomimi duhet të shprehet qartë edhe në Planin mësimor, dhe në Syllabusin përkatës lidhur me Provimin e përgjithshëm përfundimtar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në UV1 funksionon NJSBCVI <sup>143</sup> , struktura dhe funksionet e së cilës përcaktohen në Statutin e UV1, me funksion kryesor bashkëpunimin për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Për këtë qëllim kjo Njësi përpilon Raportin e analizës së Pyetësorëve të studentëve, për matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Të dhënat e këtij Raporti shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore, aty ku shihet e nevojshme. Në bashkërendim me NJSBCVI është edhe Drejtoria e Edukimit për Ciklin I dhe II, të cilat koordinojnë mes tyre dhe me Njësitë Kryesore/Bazë për veprimtaritë lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, p.sh. hartimin dhe pasqyrimin e të dhënave për Raportin vjetor, për bashkërendim aktivitetesh për informimin e maturantëve apo ndërveprim me aktorë në tregun e punës <sup>144</sup> .

bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera; Evidenca I.22- Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera

<sup>143</sup> Evidenca III.2A - Vendimet e SA të UV-së: Nr. 54, datë 20.04.2017; Evidenca III.2B - Vendim SA, Nr. 28 datë 22.05.2018; Evidenca III.2C - Vendim SA, Nr. 84 datë 12.12.2016; Evidenca A - Statuti i UV-së, Neni 82, pika 1; Evidenca III.32 - Informacioni i NJSBCVI-së, Shkresë Nr. 1778 Prot., datë 24.12.2019; Evidenca L - Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019; Evidenca III.33 - Struktura e UV-së 2019. (Vendim SA, Nr. 12, datë 27.02.2019, "Drejtoria e Edukimit për Ciklin I dhe II)

<sup>144</sup> 419 Evidenca J - Raporti vjetor i UV-së për vitin akademik 2018-2019; Evidenca III.34 - Relacion mbi pjesëmarrjen në "Panairin e Punës 2019", orientim për tregun e punës; Workshop-i me temë "Studentët dhe tregu i punës": <https://univlora.edu.al/2019/12/22/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/>.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Website: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



	<p>Në nivel institucioni është ngritur edhe Qendra Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal (RDC)<sup>145</sup>; një prej qëllimeve është mbështetja e metodave eksperimentale bashkëkohore; p.sh. përgatitja e Udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit në UVI. Struktura të tjera që janë parashikuar të ngrihen janë Komisionet e përhershme për Sigurimin e Cilësisë në Nivel Institucioni dhe në Nivel Njësie Kryesore.</p> <p>Lidhur me këto struktura mund të ritheksojmë atë që kemi pohuar në Standardin III.1, Kriteri 2, lidhur me Raportet Vjetore, <b>me strukturimin e tyre në përmbajtje dhe formatim, në evidentimin më qartë të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira, për secilën Njësi kryesore, dhe njësi bazë përkatëse.</b> Kjo do të ndihmonte realisht dhe konkretisht njësinë bazë dhe personelin akademik përkatës në gjithë procesin e përmirësimit të Programit të studimit, dhe përpilimin e planit të masave përkatëse. Po ashtu në Standardin I.5, Kriterin 3 kemi këshilluar për <b>tregues më të qartë dhe më të matshëm, mundësisht të institucionalizuara edhe në rregulloret përkatëse të institucionit, përfshirë këtu për edhe promovimin e arritjeve më të mira, dhe arritjet nga njëri vit në tjetrin etj.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Në RVB dhe nga intervistat me drejtuesit përkatës, RVJ konstaton se autoritetet drejtuese të FSHTN dhe DB monitorojnë cilësinë e mësimdhënies dhe angazhojnë stafin dhe studentët në hartimin e dokumentave/aktiviteteve të mëposhtme: Kërkesa buxhetore; Analiza vjetore në DB; Aktiviteti kërkimor shkencor në DB4; Trajnimet periodike të personelit; Tërheqja e kërkesave/mendimeve të studentëve; Pyetëtori i studentëve; Këshillimi akademik etj. DB zhvillon takime periodikisht për diskutimin e standardeve të cilësisë, çështje të menaxhimit të programeve dhe marrjen e vendimeve kolegjiale të përmbledhura në analizën vjetore të DB<sup>146</sup>. Gjithashtu, Raporti i rezultateve të pyetësorëve dhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBCVI i përcillen Njësive Kryesore, të cilat informojnë personelin akademik, më ndihmë të përmirësimit të Programit. Studentët janë të përfshirë jo vetëm në plotësimin e Pyetësorit por dhe në fushatat informuese dhe promovuese për plotësimin e Pyetësorit, Sondazhit kombëtar të studentëve, si dhe në grupe të ndryshme të</p>

<sup>145</sup> Evidenca A - Statuti i UV-së, Kreu II, Neni 12; Evidenca N - Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve

<sup>146</sup> Evidenca I.19- Raporti vjetor i punës mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore në DB, Janar 2018-Shtator 2019; Evidenca II.32 - Aktiviteti i kërkimit shkencor të personelit të DB-së; Evidenca II.32 - Aktiviteti i kërkimit shkencor të personelit të DB-së; Evidenca III.22 - Kërkesa buxhetore të Këshillit Studentor, Shkresa Nr. 1779 Prot., datë 24. 12. 2019; Evidenca III.32 - Informacioni i NJSBCVI-së, Shkresë Nr. 1778 Prot., datë 24.12.2019

	ngritura me qëllim përpilimin ose rishikimin e instrumentave të vlerësimit të brendshëm <sup>147</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Në RVB dhe nga intervistat me drejtuesit përkatës, RVJ konstaton së Qendra Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal (RDC) <sup>148</sup> , mbështet metodat eksperimentale bashkëkohore. Kjo qendër është hartuese e Udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit në UV1.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Personeli akademik i DB kanë realizuar një sërë trajnimesh, kryesisht në fushën laboratorike dhe në terren, duke ndihmuar me eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja në këta komponentë mësimorë. Aktualisht, dy prej pedagogëve janë në proces kualifikimi në kërkim dhe mësimdhënie në Poloni, në kuadër të projektit Erasmus + <sup>149</sup> . Gjithashtu, me mbështetjen e Institucionit, DB fton vazhdimisht profesorë të spikatur të fushës së Biologjisë, me aktivitet të pasur mësimdhënës e kërkimor <sup>150</sup> . Aktiviteti kërkimor-shkencor i personelit të DB-së, për vitet 2016-2020, është përmbledhur në tabelat 19 dhe 20 të Aneksit të RVB-së <sup>151</sup> , ku jepet numri i botimeve shkencore (80) dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore (107).  <b>GVJ rithekson sa është pohuar në Standardin II.2, Kriteri 4, se DB duhet të nxitë më tej kualifikimin e Personelit të ri. Këtu ka shumë rëndësi dhe përdorimi i treguesve sa më të matshëm, mundësisht të institucionalizuar, përfshirë këtu edhe mundësinë e promovimit të arritjeve më të mira.</b>
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Në RVB dhe nga intervistat me palët përgjegjëse në DB mund të pohojmë se Institucioni mbështet vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja. Kjo bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në projektet kërkimore e në mënyrë të veçantë në mobilitetet (të mundësuarat prej programit ERASMUS+) dhe nëpërmjet trajnimeve LLL të Qendra Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal (RDC) <sup>152</sup> . Përgjegjësia dhe angazhimi i personelit janë nën monitorimin e
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të	

<sup>147</sup>Evidenca I.19 - Raporti vjetor i punës mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore në DB, Janar 2018-Shtator 2019; Evidenca III.32 - Informacioni i NJSBCVI-së, Shkresë Nr. 1778 Prot., datë 24.12.2019; Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabela 24

<sup>148</sup> Evidenca A - Statuti i UV-së, Kreu II, Neni 12; Evidenca N - Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve

<sup>149</sup>Evidenca II.24 - Mobilitet stafi

<sup>150</sup>Evidenca III.14 - Ngarkesat mësimore të 4 viteve të fundit

<sup>151</sup> Evidenca II.32 - Aktiviteti i kërkimit shkencor të personelit të DB-së; Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabelat 19 dhe 20

<sup>152</sup>Evidenca I.20 - Lista e marrëveshjeve ndërinstitutionale dhe lista e mobilitetit staf-student në FSHT; Evidenca II.24 - Mobilitet stafi; Evidenca II.25 - Mobilitet student; Evidenca I.24 - Raport aktivitetesh i Qendrës së Zhvillimit Rajonal, Shkresë, Nr. 78 Prot., datë 14.01.2020

studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Drejtuesit të DB, i cili analizon aktivitetin akademik dhe shkencor të tyre në analizat vjetore të departamentit <sup>153</sup> .			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Aplikimi i metodave të reja të mësimdhënies prej personelit akademik bazohet në Udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit. Metoda të reja përdoren prej personelit akademik të programit të studimit, bazuar edhe në nisma personale apo edhe prej sugjerimeve të studentëve në pyetësorë, nëpërmjet Raportit të analizës së NJSBCVI <sup>154</sup> . Personeli akademik i DB realizon edhe testime në mënyrë individuale, por që shërbejnë si instrument matës i pritshmërive individuale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhënënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në Rregulloret e UV1, FSHTN, DB, Programit <sup>155</sup> , të cilat gjenden online në faqen e Institucionit. Këto forma paracaktohen në syllabuset lëndore <sup>156</sup> nga titullarët e lëndëve, të cilat përfshijnë një provim të pjesshëm, vlerësimin vjetor dhe një provim final. Vlerësimi vjetor përfshin vlerësimin e seminareve, laboratoreve, praktikave në terren, detyrave të kursit, projekteve etj. Në ndihmë të informimit të studentëve janë edhe koordinatori për marrëdhëniet me studentët, sekretaria mësimore, zyra e studentit, etj.
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Në fillim të çdo semestri, pedagogët dhe koordinatori për marrëdhëniet me studentin i orientojnë studentët mbi organizimin e syllabuseve lëndore dhe metodologjinë e testimit, vlerësimit të njohurive, të parashikuara në to. Titullarët e lëndëve i informojnë

<sup>153</sup>Evidenca I.19 - Raporti vjetor i punës mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore në DB, Janar 2018-Shtator 2019

<sup>154</sup> Evidenca N - Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve; Evidenca L - Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019.

<sup>155</sup> Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VII, Nenet 60,61; Evidenca II.14 - Rregullore e FSHT-së, Kreu VI, Nenet 21, 22; Evidenca I.2 - Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreu II, Neni 19; Evidenca I.5 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu III, Nenet 10, 11

<sup>156</sup>Evidenca II.1 - Syllabuset lëndore; Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabelat 15

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	studentët në auditor ose përmes postës elektronike, ku dërgohen syllabuset ose materialeve të tjera që mbështesin procesin mësimor <sup>157</sup> .			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në varësi të lëndës ose modulit të programit të studimit Bachelor në “Biologji”, testimi, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Mbështetur në Rregulloret e Institucionit, testimi mund të jetë me gojë, me shkrim ose të kombinuara, gjatë të gjithë semestrit. Ndërtimi i testit mbështetet në materialin e trajtuar në leksione, seminare, laboratore dhe/ose praktika në terren. Testi përfshin forma të ndryshme testimi si: pyetje me alternativa, pyetje shtjelluese, komente skemash, paraqitje skemash, etj., secila me pikëzim të caktuar (në Dosje jepet një shembull testi). Vlerësimi mund të jetë edhe i vazhduar gjatë të gjithë vitit me peshë 20%-30%. Këto jepen në tabelën 15 të Aneksit të RVB <sup>158</sup> . Prezantimi i detyrave të kursit dhe projekteve bëhet në mënyrë individuale ose në grup (në Word, në PPT dhe/ose me postera ose makete), por vlerësimi bëhet në mënyrë individuale, sipas kontributit të secilit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Mbështetur në Rregulloren e UVi <sup>159</sup> , në RVB dhe nga anketimet konstatohet se, vlerësimi është i vazhduar gjatë të gjithë vitit akademik dhe përfshin një provim të pjesshëm (me peshë 20%-30%), vlerësimin vjetor dhe një provim final. Vlerësimi vjetor (me peshë 10%-20%) përfshin seminarët, laboratorët, praktikat në terren, detyrat e kursit, projektet etj.; këto duhet të ndiqen 100%, në të kundërt ajo lëndë ndiqet sërish në vitin pasardhës.  Në provimin e fundit, nëse vlerësohet me notë jo kaluese (4 ose NP), mund të ristetohet në një kohë të dytë gjatë vitit akademik. DB miraton datat, oraret dhe sallat për këto riprovime dhe ia përcjell Dekanit për miratim <sup>160</sup> , të cilat mund të jenë në Shtator dhe në Janar

<sup>157</sup> Evidenca II.13 - Relacion drejtuar Drejtuesit të Njesisë Bazë nga koordinatori për marrëdhëniet me studentin; Evidenca III.23 - Komunikimi i pedagogëve me studentët nëpërmjet postës elektronike; Faqja facebook e DB-së: <https://www.facebook.com/Departamenti-i-Biologjise-FSHT-Vlore-152327005687991/>

<sup>158</sup> Evidenca III.35 - Teza të provimeve për Programin e Studimit Bachelor në “Biologji”; Evidenca III.36 - Proces-verbale finale të vlerësimit të studentëve; Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabelat 15

<sup>159</sup> Evidenca C - Rregulloret e UV-së e ndryshuar, Kreu VII, Neni 61; Evidenca III.36 - Proces-verbale finale të vlerësimit të studentëve

<sup>160</sup> Evidenca III.37 - Oraret e provimeve në DB, Vjeshtë 2016-Vjeshtë 2019; Evidenca II.22 - Kalendari Akademik: <https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/kalendari-UV-2018-2019.pdf>; Evidenca II.22 - Kalendari

	(të vitit pasardhës), dhe në periudhën e paradiploimit për studentët që kanë 1-2 provime për të shlyer, para mbrojtjes së diplomës. Në fund të vitit akademik, studentët që kanë plotësuar numrin e duhur të krediteve diplomohen me anë të provimit të diplomimit, i cili mund të jetë me shkrim, me gojë ose me temë. DB miraton datat, oraret dhe sallat e provimeve të diplomimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në UVL, ende <b>nuk është vënë në zbatim sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit të studentëve</b> . Në RVB dhe nga intervistat pohohet se Institucioni ka nëpërdorim një sistem menaxhimi të informacionit prej vitit 2008, në lidhje me vlerësimin dhe dhënien e rezultateve të provimeve për studentët. Ky ka pësuar ndryshime në vite; prej 2017 është sistemi UVMS ( <a href="https://uvms.univlora.edu.al/user/login">https://uvms.univlora.edu.al/user/login</a> ), i cili përdoret për të menaxhuar procesin e mësimdhënies (regjistrim në kurse, dërgimi materialesh lëndore, raportim problemesh me sistemin), të vlerësimit (hedhja në sistem e vlerësimeve, njoftim për vlerësimet, vëzhgim dhe printimi i transkripteve nga studentët, printimi i procesverbaleve nga pedagogët etj.), dhe plotësimit të pyetësorëve nga studentët <sup>161</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në zbatim të Rregullores së Programit <sup>162</sup> , testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për studentët bëhet nga pedagogët titullarë të lëndëve si vijon: kur pedagogu mbulon të gjithë elementët mësimorë të një lënde (seminare, laboratore, praktika mësimore në terren etj.), vlerësimi i tyre kryhet vetëm prej tij; kur për elementët mësimorë janë përgjegjës më shumë se një pedagog, vlerësimi vjetor kryhet me pjesëmarrjen e të gjithë pedagogëve, por vlerësimi final dhe regjistrimi i notave në UVMS bëhen vetëm nga titullari i lëndës. Në rastin e provimeve përfundimtare të secilës lëndë DB ngre komisione me të paktën 2 pedagogë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës; për provimin e diplomës komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Komisionet miratohen nga Dekani, përpara publikimit të datave të provimeve dhe të diplomës. Vlerësimi final i studentit llogaritet nga mesatarja e thjeshtë arithmetike e vlerësimeve të secilit pedagog anëtar i komisionit dhe procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të	Në RVB dhe nga anketimet konstatohet se në UVL, përfshirë dhe DB, <b>testimi i njohurive, dijeve me shkrim, nuk zhvillohet më në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim</b> , por ky proces, i administruar përmes UVMS garanton anonimat dhe transparencë <sup>163</sup> . Çdo titullar hedh rezultatet e provimeve dhe të vlerësimit vjetor për çdo student në lëndën e vet përmes llogarisë personale në UVMS, jo

Akademik: <https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/kalendari-UV-2018-2019.pdf>; Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB

<sup>161</sup>Evidenca III.25 - Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit në UV

<sup>162</sup> Evidenca I.5 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu III, Neni 9; Evidenca III.36 - Proces-verbale finale të vlerësimit të studentëve; Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB; Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VIII, Neni 65

<sup>163</sup> Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VIII Nenet 60, 61; Evidenca I.5 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Neni 10; Evidenca III.36 - Proces-verbale finale të vlerësimit të studentëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Website: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<p>monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>më vonë se 48 orë nga data e zhvillimit të tij. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, studentët kanë të drejtë të shikojnë tezën e provimit në prani të titullarit të lëndës, për sqarimet e duhura. Pasi pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve, printohet proces-verbali nga sistemi, firmoset nga titullari dhe dorëzohet në Sekretarinë Mësimore. Titullari i lëndës është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Në RVB dhe nga anketimet me personelin akademik konstatohet se DB dhe personeli akademik i Programit zbatojnë rregullat dhe marrin masa për shmangien e mashtrimit akademik (kopjimit në provime, detyra) dhe plagjiaturës, të përcaktuara në Rregulloren e UVI, Rregulloren e DB, Rregulloren e Programit të Studimit, Syllabuset lëndore.<sup>164</sup></p> <p>Studentët, kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës të UVI<sup>165</sup>, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në këtë universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në RVB dhe nga anketimet me personelin akademik konstatohet se vlerësimi dhe kontrolli i dijeve në DB mbështetet në Rregulloren e UVI, Rregulloren e DB, Rregulloren e Programit të Studimit, Syllabuset lëndore dhe Kodin e Etikës së UVI. Programi i studimit u garanton studentëve të drejtën për vlerësimin dhe marrjen e rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale që bazohen mbi meritën: Testet e provimit ndërtohen mbështetur në materialin e trajtuar në leksione, seminare, laboratore dhe/ose praktika mësimore në terren. Testet<sup>166</sup> përfshijnë forma të ndryshme të vlerësimit të njohurive si: pyetje me alternativa, pyetje shtjelluese, komente skemash, paraqitje skemash etj. Çdo test ka të përcaktuar qartë pikët për secilën pyetje, që synon kontrollin e dijeve dhe aftësive, vlerësimin që merr studenti për atë pyetje dhe vlerësimin e përgjithshëm.</p> <p>Në syllabuset lëndore, të pasqyruara edhe në tabelat e Aneksit të RVB<sup>167</sup> janë të përcaktuar qartë pesha e vlerësimit të çdo veprimtarie mësimore. Në bazë të konvertimit të vlerësimit total nga 41-100%, vlerësimi bëhet me notë 5-10, progresivisht. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë, por edhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në dokumentacionet e mësipërme. Çdo titullar lënde hedh rezultatet e provimeve dhe të vlerësimit vjetor për</p>

<sup>164</sup> Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu X, Neni 82; Evidenca I.2 - Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreu II, Neni 16; Evidenca I.5 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu IV, Neni 22; Evidenca II.1 - Syllabuset lëndore

<sup>165</sup> Evidenca E - Kodi i Etikës në UV, Neni 8, pika 6 dhe 8; Neni 9, pika 8 dhe 9.

<sup>166</sup> Evidenca III.35 - Teza të provimeve për Programin e Studimit Bachelor në "Biologji"

<sup>167</sup> Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabelat 15

*Redi?*

*Thun*

	çdo student në lëndën e vet përmes llogarisë personale në UVMS, jo më vonë se 48 orë nga data e zhvillimit të tij. Në rast se pedagogu në mënyrë të pajustificuar, nuk ka hedhur rezultatet e provimeve në sistem, DB dhe Dekani marrin masat disiplinore.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Konstatohet se në UVI përfshirë dhe DB, bazuar në dokumentacionet e mësipërme, garantoen edhe të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht tezën e provimit, në prani të titullarit të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Kjo shoqërohet me sqarime, nëse është e nevojshme mund të shoqërohet edhe me këshilla për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen <sup>168</sup> . Pasi pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve, printohet proces-verbali nga sistemi, firmoset nga titullari dhe dorëzohet në Sekretarinë mësimore <sup>169</sup> .			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë ose ankimim, shqyrtohet fillimisht nga pedagogët e lëndëve përkatëse, ose nga komisioni i diplomimit (në rastin e provimeve të diplomimit). Nëse studenti ka përsëri ankesa, ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim në sekretarinë mësimore. Brenda 48 orëve drejtuesi i DB informon Dekanin. Dekani ngre një komision apelimi <i>ad hoc</i> (brenda 48 orëve të informimit nga drejtuesi i DB) për vlerësimin e kërkesës së studentit <sup>170</sup> . Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga çasti i kërkesës për rivlerësim. Pikët përfundimtare të testit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.  Konstatohet se në DB, nuk ka patur raste të ankimeve të vlerësimeve prej studentëve. Pedagogët e DB-së, i kanë pritur, sqaruar dhe këshilluar studentët për tezën e provimit, duke respektuar etikën akademike.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e	Programi i Studimit është organizuar dhe zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve në fushën e Biologjisë.

<sup>168</sup>Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Neni 53

<sup>169</sup>Evidenca III.36 - Proces-verbale finale të vlerësimit të studentëve

<sup>170</sup>Evidenca II.14 - Rregullore e FSHT-së, Kreu VI, Neni 23

njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Organizimi Programit është sipas veprimtarive formuese është në përputhje me VKM 41/2018 <sup>171</sup> : 15 lëndë (68%) kanë laboratore dhe 4 lëndë përfshijnë edhe praktika në terren; këto mundësojnë krijimin e aftësive profesionale nëpërmjet përdorimit të instrumentave laboratorike dhe punës në terren. Gjithashtu, detyrat dhe projektet e kursit sigurojnë thellimin e njohurive, zhvillojnë aftësitë profesionale, si të menduarit kritik, të mësuarit e bazuar në problem, komunikimin etj.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në Program përfshihen lëndë ndërdisiplinore/integruese (Kategoria C) gjithsej 25 kredite <sup>172</sup> , si Teknologji Informacioni dhe Telekomunikacionidhe Anglisht (lëndë plotësues); këto përfshijnë leksione, seminare, laboratore (CS130), detyra kursi dhe/ose projekte, të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në teknologji informacioni, por dhe në fushat humane, sociale, komunikim dhe ndërveprim (edhe në gjuhë të huaj).
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	GVJ konstaton se në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik i DB <sup>173</sup> analizon e shqyrton aftësitë që fiton studenti dhe vë në pah çështjet më të rëndësishme për ta. Në fund të semestrit, hartohen relacionet përkatëse, ku paraqiten: zhvillimi i temave përkatëse, gjendja e mjeteve të punës, ndikimi i tyre në realizimin e temave përkatëse. Ecuria e procesit mësimor për secilën lëndë/modul shqyrtohet edhe gjatë diskutimeve dhe në analizën vjetore të punës në DB, ku analizohet cilësia e kalueshmëria e secilës lëndë, pas vlerësimit final.  Si është theksuar edhe në Standardin III.4, në DB <sup>174</sup> , merret në shqyrtim Raporti i NJSBCVI për pyetësorët dhe rekomandimet përkatëse duke parashikuar masa për përmirësimin e cilësisë së Programit.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Gjithashtu, gjatë zhvillimit të lëndës, përpara provimit të pjesshëm dhe në përfundim të çdo lënde/moduli (përpara provimit final), personeli akademik i DB vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre. Për këtë, secili titullar lënde organizon konsultime me studentët përpara provimit përfundimtar ose të pjesshëm, në mënyrë të vazhdueshme, të parashikuara në syllabus.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe	Në RVB dhe nga anketimet me personelin akademik konstatohet se personeli akademik i DB <sup>175</sup> realizon leksione të hapura, workshope,

<sup>171</sup> Evidenca I.6 - Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji"; Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabela 9; VKM, Nr. 41, datë 24.01.2018

<sup>172</sup> Evidenca II.1 - Syllabuset lëndore

<sup>173</sup> Evidenca III.38 - Relacion i analizave të lëndëve dhe moduleve në përfundim të semestrit; Evidenca II.23 - Relacion i punëve laboratorike në DB; Evidenca I.23 - Raportet e zhvillimit të praktikave mësimore në terren; Evidenca I.19 - Raporti vjetor i punës mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore në DB, Janar 2018-Shtator 2019

<sup>174</sup> Evidenca III.5 - Kthim përgjigje i DB-së në lidhje me raportin e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2018-2019, Shkresë, Nr. 138/2 prot., datë 04.03.2020; Evidenca III.3 - Vendim SA, Nr. 21, datë 08.05.2018, Procedurë e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies

<sup>175</sup> Evidenca III.15 - Leksionet e hapura në DB; Evidenca III.16 - Aktivitete të DB-së me studentët



seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	konkurse etj., mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë. Këto kryhen brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit, në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti, duke përfshirë edhe studentët.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Programi <sup>176</sup> është i ndërtuar mbi bazë kompetencash, nëpërmjet zhvillimit të leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe praktikave në terren. Ritheksojmë se 15 lëndë (68%) kanë laboratore dhe 4 lëndë përfshijnë edhe praktika në terren; këto mundësojnë krijimin e aftësive profesionale nëpërmjet përdorimit të instrumentave laboratorike dhe punës në terren. Gjithashtu, detyrat dhe projektet e kursit sigurojnë thellimin e njohurive, zhvillojnë aftësitë profesionale, si të menduarit kritik, të mësuarit e bazuar në problem, komunikimin etj.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga RVB dhe intervistat konstatohet se personeli akademik i DB mbështet, krijon kushtet dhe nxit diskutimet dhe punën në grup <sup>177</sup> . Kjo shprehet edhe në rezultatet e Pyetësorit, në interpretimin dhe zgjidhjen e çështjeve të caktuara gjatë leksioneve, seminareve (ku përfshihen edhe ushtrime/probleme, detyra kursi ose projekte) dhe laboratorëve etj.
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetjetë studentëve.	Konstatohet se personeli akademik i DB, krijon klimë të përshtatshme, si pjesë e Planit Strategjik për Programin e Studimit <sup>178</sup> , nëpërmjet: punës së diplomës; konferencave studentore; përfshirjes në projekte kërkimore dhe studimore; detyrave të kursit; pjesëmarrjes në Workshope dhe konferenca shkencore. Këto aktivitete janë mbështetur nga UVI, FSHTN dhe DB. Pohohet se studentët e Programit kanë qenë aktivë në këto veprimtari.
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështetfinanciarisht studentët.	UVI ka mbështetur financiarisht organizimin e konferencave studentore <sup>179</sup> në funksion të zhvillimit të ideve inovative, në përaprimin në studimet kërkimore e shkencore.

<sup>176</sup> Evidenca I.6 - Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji", Objektivat formues; Evidenca II.1 - Syllabuset lëndore

<sup>177</sup> Evidenca III.16 - Aktivitete të DB-së me studentët; Evidenca L: Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019; Evidenca III.5 - Kthim përgjigje i DB-së në lidhje me raportin e analizës dhe vlerësimin të pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2018-2019, Shkresë, Nr. 138/2 prot., datë 04.03.2020; Evidenca III.16 - Aktivitete të DB-së me studentët

<sup>178</sup> Evidenca I.4 - Plani Strategjik 2017-2024 për Programin e Studimit Bachelor në "Biologji", faqe 5; Evidenca L: Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019; Evidenca III.5 - Kthim përgjigje i DB-së në lidhje me raportin e analizës dhe vlerësimin të pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2018-2019, Shkresë, Nr. 138/2 prot., datë 04.03.2020;

<https://univlora.edu.al/2017/12/15/konferenca-studentore-e-hapur-2017/>; Evidenca III.21 - Projekti AFRIMED; Evidenca III.16 - Aktivitete të DB-së me studentët; Evidenca III.21 - Projekti AFRIMED; <https://www.researchgate.net/project/Konferenca-Shqiptare-e-Biologjise-Mjedisit-Albanian-Conference-on-Biology-Environment, fq 190>; Evidenca II.13 - Relacion drejtuar Drejtuesit të Njësisë Bazë nga koordinatori për marrëdhëniet me studentin

<sup>179</sup>Evidenca III.39 - Mbështetja financiare e konferencës studentore.

<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	UVI dhe personeli akademik i DB ka marrë pjesë gjerësisht në aktivitete ndërkombëtare dhe në bashkëpunimet si partner në projekte ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe ato ERASMUS +, nëpërmjet të cilave është mundësuar mobiliteti i studentëve dhe i personelit akademik <sup>180</sup> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk është përmbushur</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>Procedura e diplomimit në Programin është e përcaktuar në Rregulloret e UVI, DB, dhe më tej në Rregulloret e Programit të Studimit dhe të Diplomimit<sup>181</sup>, dhe është gjithashtu e bërë publike. Studentët që plotësojnë 174 kredite aplikojnë për diplomim në Sekretarinë mësimore të DB. Diplomimi mund të jetë me provim me shkrim, provim me gojë ose me punë diplome. Kjo përcaktohet në bazë të mesatares së studentëve, e cila verifikohet nga Sekretaria mësimore në fillim të semestrit të dytë, në vitin e tretë.</p> <p>GVJ rithekson komentet në Standardin II.1, Kriterin 1, lidhur me veprimtarinë ‘Tezë diplome’ (BIO 398)<sup>182</sup>, me 6 kredite në Program. Kjo veprimtari përmbyllëse është Punë diplome vetëm për kandidatë të zgjedhur me mesatare note mbi 8 gjatë 2 viteve të para bachelor, kurse studentët e tjerë i nënshtrohen ‘Provimit të përgjithshëm përfundimtar’. Kjo duhet të dalë qartë në Planin mësimor, dhe në Programet lëndore<sup>183</sup>.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në	Në RVB dhe dokumentat në Dosje theksohet se Sekretaria mësimore dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. Programi orientues i diplomimit me Provim u jepet studentëve nga Sekretaria, ose DB (me e-mail ose në faqen web), në fillim të semestrit të fundit. Gjithashtu, edhe

<sup>180</sup>Lista e plotë e marreveshjeve ndër institucionale: <https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/marreveshje-ndërinstitucionale/>; Evidenca II.25 - Mobilitet student; Evidenca II.25 - Mobilitet stafi; Evidenca I.20 - Lista e marrëveshjeve ndër institucionale dhe lista e mobilitetit staf-student në FSHT

<sup>181</sup> Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në “Biologji” në DB; Evidenca C - Rregulloret e UV-së e ndryshuar, Kreu VIII, Neni 65; Evidenca I.2 - Rregulloret e Departamentit të Biologjisë, Kreu II, Neni 19; Evidenca I.5 - Rregulloret e Programit të Studimit Bachelor në “Biologji”, Kreu III, Nenet 15,16; Evidenca III.40 - Rregulloret e Diplomimit; Vendim rektorati Nr. 05, datë 24.01.2017 “Për miratimin e pragut të notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë “Master Profesional” të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome”

<sup>182</sup>Evidenca I.6- Programi Mësimor i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Biologji”.PDF

<sup>183</sup>Evidenca II.1- Syllabuset lëndore.PDF


<p>funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>diplomimi me punë diplome ka procedurën e vet, sipas së cilës, pasi studenti merr temën, në fillim të semestrit të fundit, duhet të asistohet nga pedagogu udhëheqës dhe të realizojë kërkim teorik, punë praktike, përpunim të dhënash etj. Një dokument i tillë është edhe në Dosje për vitin 2017<sup>184</sup>.</p> <p>Në vazhdim, drejtuesi i DB ngre komisionet <i>ad hoc</i> të verifikimit të transkripteve e të diplomimeve, miraton datat, oraret dhe sallat e diplomimi, dhe i përcjell në dekanat. Pas miratimit, dokumentacionet e mësipërme bëhen publike, duke i afishuar në stendat përkatëse të FSHTN dhe në faqen web të DB.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisionet e diplomimit përbëhen së paku nga 5 anëtarë me tituj e grada shkencore, që mbulojnë disiplina të Programit, administrojnë procesin e diplomimit. Një ditë para datës së diplomimit me provim, Komisioni harton tezat mbështetur në Programin e diplomimit, që përfshin testimin e njohurive në lëndët bazë, karakterizuese e ndërdisiplinore gjatë tri viteve. Provimi është me shkrim ose me gojë, zhvillohet në përputhje me kërkesat e Rregullores UV1<sup>185</sup>. Komisioni i Punës së diplomës analizon punën paraprakisht; mbrojtja bëhet e hapur, me prezantim të punimit, pyetje dhe përgjigje, dhe vlerësim me notë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Nga RVB, dokumentacioni dhe intervistat me personeli akademik dhe studentët mund të pohohet se personeli akademik asiston, orienton dhe ndihmon studentët për Provimin përfundimtar, dhe pedagogu udhëheqës për punën e diplomës, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës<sup>186</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në rastin e diplomimit me Punë diplome, studenti së bashku me pedagogun udhëheqës përcaktojnë planin e detajuar të punës, bazuar në fushën e studimit të përcaktuar, ku përfshihen, zona e studimit/objekti i studimit dhe aza materiale (reagentë dhe paisje të ndryshme). DB asiston studentët diplomantë me bazën materiale prej laboratorëve (i Botanikës, i Zoologjisë etj.), për kryerjen e matjeve, analizave, testeve të ndryshme në funksion të temave të diplomës. Disa punë diplomash janë realizuar edhe me mbështetjen e institucioneve me të cilat DB ka realizuar marrëveshje zyrtare. Për vitin akademik 2019-2020 është realizuar përfshirja për punë diplome e një studenteje në projektin AFRIMED<sup>187</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen</p>	<p>Pasi studenti merr temën e diplomës, orientohet nga pedagogu udhëheqës për planin e punës dhe ndihmohet prej tij për kërkimin teorik, punën praktike, përpunimin e të dhënave, etj. Në çdo hap studenti</p>

<sup>184</sup>Evidenca II.16- Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB.PDF

<sup>185</sup> Evidenca III.41 - Programi Orientues për diplomimin e studentëve në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji"; Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB; Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VII, Neni 61

<sup>186</sup>Evidenca III.23 - Komunikimi i pedagogëve me studentët nëpërmjet postës elektronike

<sup>187</sup> Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB; Evidenca I.22 - Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera; Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB; Evidenca I.22 - Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera; Evidenca III.21 - Projekti AFRIMED

e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temëssipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	komunikon në mënyrë të vazhdueshme me udhëheqësin, duke ndjekur të gjitha hapat për punën dhe shkrimin e punimit duke zbatuar Rregulloren e diplomimit dhe Udhëzuesin për punën e diplomës. Udhëheqësi garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit <sup>188</sup> .
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Mbrojtja e punës së diplomës bëhet para Komisionit së paku nga 5 anëtarë me tituj e grada shkencore, që mbulojnë disiplina të Programit, studenti vlerësohet me notë, bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e diplomimit. Komisioni i Punës së diplomës analizon punën paraprakisht; mbrojtja bëhet e hapur, me prezantim të punimit, pyetje dhe përgjigje, dhe vlerësim me notë, e dokumentuar në procesverbalin përkatës, të dokumentuara te procedura e diplomimit <sup>189</sup> .
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në Statutin e UV dhe në Rregulloret e UV, DB, Programit të Studimit, Diplomimit, studentët që kanë plotësuar detyrimet e Programit dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt UVI, pajisen me diplomë, e cila është një dokument zyrtar. Diploma shoqërohet me Listën e notave (ku pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese $\geq 5$ të çdo lënde si dhe kreditet përkatëse) dhe me Suplementin e Diplomës <sup>190</sup> , i hartuar në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e MASR. Diploma nënshkruhet nga Dekani dhe Rektori, dhe shoqërohet me vulën e UVI.
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Programi i plotë i studimit vihet në dispozicion të studentit me kërkesë të tij. Studenti tërheq formularin përkatës tek Sekretaria mësimore e DB, bën pagesën në çdo bankë të nivelit të dytë, dhe më pas tërheq programin e firmosur dhe të vulosur nga Rektori, brenda një periudhe prej 10 ditësh.
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas	Bazuar në Statutin e UVI, Rregulloren e UVI dhe të DB <sup>191</sup> , Sekretaria mësimore e DB dhe e FSHN mbajnë regjistër themeltar, të arritjeve akademike, të lëshimit të diplomave të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së Programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me

<sup>188</sup> Evidenca III.23 - Komunikimi i pedagogëve me studentët nëpërmjet postës elektronike; Evidenca III.40 - Rregullore e Diplomimit; Evidenca III.42 - Udhëzues për punimin e Diplomës Bachelor; Evidenca III.43 - Shtojca 4 në vendimin e SA, Nr. 65, datë 14.11.2016

<sup>189</sup> Evidenca I.5 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu III, Neni 15; Evidenca III.40 - Rregullore e Diplomimit; Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB

<sup>190</sup> Evidenca II.16 - Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB; Evidenca A - Statuti i UV-së, Kreu VI, Neni 71; Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VIII, Neni 66; Evidenca I.2 - Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreu II, Neni 16; Evidenca I.5 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu II, Neni 19; Evidenca III.40 - Rregullore e Diplomimit; Evidenca III.44 - Formatit i Diplomës Bachelor në "Biologji"; Evidenca II.3 - Suplementi i Diplomës Bachelor në "Biologji"

<sup>191</sup> Evidenca A - Statuti i UV-së, Kreu VII, Neni 78, 79; Evidenca C - Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu V, Neni 54; Kreu XI, Neni 90; Evidenca I.2 - Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreu III, Neni 21

*ASCA*

*[Signature]*

<p>rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe mbahet në ruajtje të përhershme.</p> <p>Sekretaria mësimore e DB përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrin themeltar (bazë) të shkruar me dorë. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye<sup>192</sup>. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet prej Sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri.</p> <p>Bazuar edhe në Rregulloren e Programit të studimit<sup>193</sup>, Sekretaria mësimore e DB ruan provimet e studentëve deri në fund të semestrit pasardhës e më pas ato asgjësohen. Ndërsa DB ruan detyrat e kursit, projektet, fletoret e laboratorit, dosjet e praktikave mësimore në terren, etj., deri në fillim të vitit tjetër akademik. Gjithashtu, një kopje e punimeve të diplomave ruhen në fondin e DB në mënyrë të përhershme dhe një kopje tjetër ruhet në sekretarinë mësimore<sup>194</sup>.</p> <p>Nga intervistat me Sekretarinë mësimore GVJ konstaton se nuk ka të dokumentuara auditime të brendshme të saktësisë së përpunimit të informacionit të vlerësimeve nëpërmjet procesverbaleve të personelit akademik me ato të Regjistrin themeltar dhe sistemit elektronik UVMS. Këshillojmë që Institucioni të sanksionojë në Rregulloret përkatëse mënyrën e sigurisë/saktësisë së ruajtjes së sistemit të vlerësimit (notave), dhe parandalimin e gabimeve qoftë edhe njerëzore, dhe promovimin për auditimet me saktësi të lartë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>


**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<p><b>Standardi IV.1</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<sup>192</sup>Evidenca III.45 - Demonstrim në regjistrin themeltar të studentëve

<sup>193</sup>Evidenca I.5 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu III, Neni 12, pika b

<sup>194</sup>Evidenca I.2 - Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreu III, Neni 21






<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Spektori përgjegjës në lidhje me të dhënat që i përkasin dosjeve të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit është Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës, pjesë e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore<sup>195</sup>. Ky sektor, gjithashtu ka detyra të përcaktuara qartë në plotësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të dhënave sipas periudhave të ndryshme të vitit akademik. Përditësimi mbështetet në parashikimet e ngarkesës nga DB, nga relacionet e pedagogëve në procesin e realizimit të mësimin, si dhe në të dhëna të tjera nga Sekretaria mësimore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga kontaktet me sektorin përkatës GVJ vëren se ky Sektor i ka organizuar, kompletuar dhe përditësuar me kujdes dosjet personale të personelit akademik dhe ndihmës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Mbi bazën e kërkesave dhe nevojave të zhvillimit cilësor të procesit mësimor dhe kërkimor hartohen procedurat për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore ekzistuese, si dhe rregullat dhe rregulloret e brendshme, si për shembull Ligji 80/2015<sup>196</sup>, apo akte të tjera rregullatore të vetë UV1<sup>197</sup>. Për këtë u konstatua zbatimi i plotë i procedurave duke synuar rekrutimin e kandidatëve më të mirë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriterete e përgjithshme në rekrutimin e personelit përcaktohen sipas udhëzimeve të Statutit të UV1 (Nenet 51, 52); DB merret me përcaktimin e kriterëve të veçanta në bazë të kërkesave të veçanta. Në të gjithë këtë proces, për miratimin e tyre, kriteret ndjekin rrugën e hierarkisë drejt Dekanit dhe Rektorit. GVJ konstaton se procedurat e tilla, si dhe shpallja e njoftimeve për punësim janë të hapura dhe publike</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga kontaktet me personelin akademik si dhe me personelin e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës, pjesë e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore u konstatua ndjekja e rregullt dhe korrekte sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara më parë në lidhje me përzgjedhjen dhe më pas rekrutimin e personelit në përputhje me cilësitë e kërkuara. Në përgjithësi përzgjedhja e personelit është në përputhje me kualifikimin e nevojshëm dhe lidhet me përmbajtjen e programeve apo moduleve të veçanta mësimore. <b>Megjithatë, DB duhet të përpiket që titullarët e lëndëve karakterizuese në Program të mbulohe të paktën nga personel me gradë shkencore (Standardi II.5, Kriteri 1); duhet të rishohë që numri i lëndëve dhe i ngarkesës mësimore vjetore së personelit të jetë në përputhje me U29(MASR) (Standardi II.5, Kriteret 1 &amp; 2); duhet të shmangë zhvillimin nga i</b></p>

<sup>195</sup>Organigrama:<https://univlora.edu.al/en-organigrama/?query=administrata#;Administrata,https://univlora.edu.al/administrata/>; EvidencaIII.33-StrukturaveUV-së2019. (VendimSA, Nr. 12, datë27.02.2019, "DrejtoriaeEdukimitpër CiklinIdhëll)

<sup>196</sup>LigjiNr.80/2015,Nenet64, 65

<sup>197</sup>EvidencaC-RregulloreeUVendryshuar,KreulX, Neni89

	<p>njëti personel efektiv të lëndëve me përbajtje nga fusha shkencore jo të afërta (Standardi II.5, Kriteri 1).</p> <p>GVJ konstaton se në vite ka patur disa largime drejt UT, e cila pa dyshim lë gjurmë në cilësinë e mësimdhënies. UVI duhet të përpiqet qoftë në sigurimin e kushteve, motivimin, por dhe rrugën e duhur ligjore që të punësuarit të mos largohen nga institucioni.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga kontaktet me drejtues të institucionit, me personelin akademik dhe ndihmës, si dhe nga vizita online e organizuar me kujdes nga institucioni, GVJ konstaton se janë ndërmarrë masa dhe nisma të lavdërueshme për krijimin e mjediseve të përshtatshme për realizimin e detyrave të veçanta të gjithë procesit mësimor. Rezulton se janë kryer rikonstruksione të ndërtesave A, B, C, janë ndërtuar dhe përshtatur mjedise për salla të leksioneve, si dhe për laboratorët tashmë në funksion të Zoologjisë, Botanikës, ku kryhen ndërkohë edhe punë laboratorit të lëndëve të tjera biologjike. Mjedise të tjera të rëndësishme në këtë funksion janë ato të Qendrës Kërkimore Shkencore të FSHTN, si dhe në bibliotekat e fakultetit të pajisura me literaturën e nevojshme dhe bashkohore. E rëndësishme mendohet edhe pajisja me reagentët e posaçëm të laboratorëve që lejojnë kryerjen cilësore të punëve laboratorike<sup>198</sup>.</p> <p>Nga ana tjetër, mjediset janë në kushte të mira cilësore lidhur me akustikë të mirë në mjediset e mësimdhënies dhe izolim nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës, si dhe kushtet higjieno-sanitare.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Në RVB pasqyrohet qartë se institucioni ka përgatitur strategji të mirëmenduara për nxitjen e përgatitjes dhe kualifikimit të vazhdueshëm teknik dhe profesional të stafit, si dokumentohet nga Plani Strategjik i UVI 2018-2024, Strategjia për Kërkimin Shkencor 2017-2022, Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2016-2020, Strategjia për Trajnimin e Vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj, etj.<sup>199</sup></p> <p>Zbatimi i planeve dhe strategjive të tilla është shoqëruar edhe me masa të tjera, si forcimi i lidhjeve dhe marrëdhënieve me programet ndërkombëtare të shkëmbimit dhe kualifikimit të stafit dhe studentëve; gjithashtu masa të rëndësishme janë marrë edhe në kuadrin e</p>

<sup>198</sup> Evidenca J-Raporti vjetor i UV-së për vitin akademik 2018-2019, fq. 166.

<sup>199</sup> Evidenca B- Plani Strategjik i UV-së 2018-2024. Strategjia për Kërkimin Shkencor 2017-2022. Evidenca D- Strategjia e Ndërkombëtarizimit. Evidenca G-Strategjia për Trajnimin e Vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj.

	<p>mbështetjes financiare të pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore apo konferenca ndërkombëtare<sup>200</sup>. Vlen të përmenden edhe veprimtaritë trajnuese të organizuara nga institucioni për përgatitjen e aplikimeve pranë organizmave të ndryshme ndërkombëtare (p.sh. “Si të shkruajmë një projekt-propozim cilësor”, me pjesëmarrjen e personelit dhe të studentëve)</p> <p>Sidoqoftë, këtu GVJ rithekson komentet që jepen në Standardin IV.1, Kriteri 4, dhe më lart lidhur me ngarkesën dhe mbulimin e lëndëve të Programit me titullarë me kualifikimin e duhur. GVJ sugjeron që pas kryerjes së kualifikimeve në institucione të huaja personi i kualifikuar duhet jo vetëm të raportojë për kualifikimin e kryer, por edhe të shpërndajë tek të tjerët përvojën e fituar. Nga ana tjetër, veprimtari të tilla për përgatitjen dhe trajnimin profesional të personelit duhet të shoqërohen edhe me përpjekje për punime dhe botime të punimeve të përbashkëta me bashkëpunëtorë të huaj pranë të cilëve kryhen trajnimet apo kualifikimet profesionale.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe nga të dhënat e RVB vërehet se institucioni nxit përmes programeve dhe veprimtarive të ndryshme zbatimin e metodave dhe teknologjive bashkohore të mësimdhënies. Kjo është realizuar përmes vënies në dispozicion të një infrastrukture bashkohore të ngritur rishtaz në mjedise të posaçme si e kemi përmendur edhe më sipër. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe zhvillimi periodik i leksioneve apo seminareve të hapura në dobi të shkëmbimit të përvojës, si dhe në zbatim të përvojës së përfutur nga trajnime jashtë shtetit. <b>Sugjerimi ynë është që veprimtari të tilla të mbeten në vazhdimësi dhe të shoqërohen edhe me shkëmbime përvoja nga institucione të tjera të vendit apo edhe të huaja kur është e mundur.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Programi është i ri i ngritur në 10 vitet e fundit dhe i organizuar nga një staf me moshë të re, i cili ka përballuar me sukses të gjitha vështirësitë e përmbushjes së objektivave përkatëse. Vërehet një punë e mirë në ndarjen e ngarkesave sipas kualifikimeve dhe kompetencave profesionale të stafit. Me punë këmbëngulëse, si dëshmohet edhe nga dokumentacioni përkatës, është arritur të rriten kapacitetet e kualifikuara të stafit në lidhje me titujt shkencorë.<sup>201</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<sup>200</sup> <https://univlora.edu.al/aktivitete/>; <https://univlora.edu.al/2020/01/24/trajnimi-mbi-shkrimin-e-nje-projekt-cilesor-prane-qendres-kerkimore-shkencore-ne-fakultetin-e-shendetit-publik/>

<sup>201</sup> Evidencall.17 –Procedura e Shpërndarjes së Ngarkesës Mësimore në DB. Evidencall.30 – Dosja me Diplomat e personelit akademik të Programit të Studimit Bachelor në “Biologji”; Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabelat 1, 2.1. Evidencall.17 –Infrastruktura e UV-së në funksion të Programeve të Studimit.



**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga RVB si dhe nga kontaktet dhe vizita virtuale në mjediset e institucionit konstatohet se institucioni ka mjedise më se të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Në të tre ndërtesat është në dispozicion një sipërfaqe totale prej prej 13,357 m<sup>2</sup> ku përfshihen 14 laboratorë, 3 klasa për zhvillimin e leksioneve dhe 4 klasa për zhvillimin e seminareve<sup>202</sup>. Organizimi dhe ndarja e këtyre klasave është realizuar në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p>Mjediset rezultojnë të pajisura me mjetet audiovizive dhe pajisje të tjera elektronike në funksion të procesit mësimor<sup>203</sup>. Nga ana tjetër, orari mësimor është në përshtatje me hapësirat dhe mjetet në dispozicion. Të gjitha këto favorizohen edhe nga numri jo i madh i studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita <i>online</i> GVJ konstatoi gjithashtu se mjediset ku zhvillohet procesi mësimor janë të pajisura më së miri me pajisjet e nevojshme dhe bashkohore<sup>204</sup> që garantojnë cilësinë e mësimdhënies. Hartimi i rregullores së Programit<sup>205</sup> ka përcaktuar me qartësi jo vetëm objektivat formuese të programit, por edhe pajisjet dhe përmirësimet e vazhdueshme të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe</p>	<p>DB ka në dispozicion një sërë laboratorësh, si ai i Botanikës dhe Biologjisë Qelizore të kompletuar me të gjitha pajisjet dhe preparatet për kryerjen e punëve laboratorike të parashikuara. E njëjta gjë mund të thuhet për laboratorët e Zoologjisë, pajisjet e të cilit lejojnë zhvillimin e punëve për disa lëndë të ngjashme, si Zoologji Invertebrore, Zoologji Vertebrore Anatomi e Krahasuar, Ekologji dhe Fiziologji shtazore etj. Përveç pajisjeve dhe mjeteve të veçanta laboratorike, në përbërje të tyre shtohen edhe elementë të grumbulluar në ekspedita në natyrë nga studentët gjatë praktikave</p>

<sup>202</sup> Evidenca III.17 - Infrastruktura e UV-së në funksion të Programeve të Studimit

<sup>203</sup> Evidenca III.18 - Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DB

<sup>204</sup> Evidenca III.18 - Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DB

<sup>205</sup> Evidenca I.5 - Rregulloret e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreul, Nen III

të objekti vave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>mësimore. Duhet përmendur gjithashtu edhe pajisja e laboratorë ve të tjerë me funksione më të përgjithshme, si ato të Kimisë, Fizikës, Informatikës etj., ku studentët kanë akses për të kryer punët laboratorike në këto lëndë.<sup>206</sup> Të gjitha këto iu vunë në dispozicion GVJ gjatë vizitës <i>online</i> pranë DB, si dhe gjatë kontakteve me stafin e tij.</p> <p>Pozitiv është fakti që nga administrata nuk ka pengesa për blerjen apo zëvendësimet e kimikateve apo elementëve të tjerë të konsumit për laboratorët.</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	<p>Në funksion të realizimit të moduleve të veçanta të Programit janë në dispozicion të DB dy laboratorë të FSHTN të pajisur më së miri me software përkatës, simulatorë në përshtatje me kursetspecifike, si dhe një seri programesh dhe paketash të tjera elektronike.<sup>207</sup></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	<p>Përmes shqyrtimit të dokumentacioni në dispozicion<sup>208</sup>, si dhe nga intervistat me stafin rezulton se institucioni i ka kapacitetet e nevojshme dhe të domosdoshme për zhvillimin normal dhe sipas parashikimeve në program të praktikave profesionale apo veprimtarive të tjera të përfshira në programet mësimore.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<sup>206</sup>Evidencial.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreul, NenIII. Evidencial.33-Relacion për inventarin e laboratorëve nëDB. Evidencial.23-Raportet e zhvillimit të praktikave mësimore në terren.

<sup>207</sup>Evidencial.23-Raportet e zhvillimit të praktikave mësimore në terren. Evidencial.22- Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera. 6Evidencial.6-Programi Mësimori Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në "Biologji".

<sup>208</sup>Evidencial.31-Procedura e praktikës mësimore në terren në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji". Evidencial.22- Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera. Evidencial.22- Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera. Evidencial.26 –Informacion për Bibliotekë nshkencore në UV

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Website: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

*Alvina*

*Armin*

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve 3 biblioteka me tre salla leximi si dhe me personelin përkatës sipas specialiteteve në të cilat ata kanë akses të plotë, në to garantohehen mundësi të barabarta në shfrytëzim nga të gjithë studentët.</p> <p>Nga vizita virtuale e GVJ rezultoi se këto biblioteka krijojnë kushte të përshtatshme dhe komode (me ngrohje dhe ftohje sipas stinëve) për shfrytëzimin racional të tyre.</p> <p>Këtu ka rëndësi edhe ndjekja nga DB e shfrytëzimit të Bibliotekës (Standardi III3, Kriteri 5), të mjediseve të saj dhe të fondit të librave, qoftë nga studentët, por edhe nga anëtarët e stafit. Kjo ka rëndësi për të parë se sa të efektshme kanë qënë hapësirat ekzistuese dhe blerjet, cilat janë kërkesat për hapësira dhe për tituj librash etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka në fondin e saj burimet kryesore të literaturës së trashëguar nga e kaluara jo e largët (1994-2016), por ajo që bie në sy është pasurimi veçanërisht në vitet e fundit i saj me literaturë bashkohore të huaj (tekste bazë, literaturë ndihmëse, revista shkencore). Fondi i literaturës është pasuruar me blerje të vazhdueshme si dhe nga dhurime nga biblioteka apo institucione të huaja. Mendojmë se literatura është e përshtatshme për të mbuluar veprimtaritë e parashikuara në programet mësimore.</p> <p>Në fondin e bibliotekës bëjnë pjesë revistat apo buletinet shkencore të botuara nga vetë UVI, si dhe ato të universiteteve të tjera të vendit, si dhe punimet shkencore të stafit apo të studentëve. Megjithatë, <b>GVJ e pati të vështirë të kuptojë nëse Biblioteka është e pajisur mirë lidhur me Programin me literaturë të 5 viteve të fundit.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me sistemin online ku studentët kanë akses pa pagesë. Studentëve u vihet në dispozicion manuali, i cili u lejon përzgjedhjen e informacionit sipas kërkesave të tyre. Softet përkatëse të instaluar pranë UVI lejojnë përditësimin e të dhënave dhe pasurimin e bibliotekës <i>online</i>. Ndërkohë, sipas RVB dhe informacionet nga stafi rezultojnë se UVI<sup>209</sup> është në proces unifikimi me rrjetin e Bibliotekave Universitare me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave, me synimin e digjitalizimit të bibliotekave universitare, si për digjitalizimin e tekstit nga botuesi/enti botues dhe për tekstin e digjitalizuar.</p> <p>Edhe këtu, mbështetur në intervistat tona me Bibliotekën dhe drejtuesit në Institucion, rezultojnë se <b>ka rëndësi edhe ndjekja nga DB (por jo vetëm) e shfrytëzimit të Bibliotekës online, e titujve të kërkuar, qoftë nga studentët, por edhe nga anëtarët e stafit.</b> Edhe këtu, kjo <b>ka rëndësi për të parë se sa të efektshme kanë qënë përpjekjet për të siguruar aksesin online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe performancën e stafit</b> (Standardi III.1, Kriteri 6).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe</p>	<p>Përveç pajisjes me programe dhe softet të veçanta kompjuterike biblioteka rezultojnë të ketë në dispozicion pajisjet teknike përkatëse si</p>

<sup>209</sup>Evidencalll.26 –Informacion për Bibliotekën shkencore në UV. Biblioteka online: Ulibrary:

<https://ulibrary.rash.al/>. Manuali i përdorimit të Bibliotekës On-Line: <https://univlora.edu.al/en/biblioteka/>.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Website: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Alsi*

*[Signature]*

kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	kompjutera etj. si vijon: Biblioteka Qendrore Ndërtesa A: 9 PC +1 projektor; Biblioteka Ndërtesa B: 4 PC; Biblioteka Ndërtesa C: 4 PC+1 projektor. Mendojmë se pajisje të tilla mundësojnë kryerjen e detyrave dhe veprimtarive të tjera pa kufizim nga ana e studentëve. <b>Por GVJ këshillon se gjithmonë duhen ndjekur dhe dokumentuar përdorimi i tyre nga personeli dhe studentët.</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga kontaktet me punonjësit e bibliotekës rezulton një ndjekje e vazhdueshme dhe e planifikuar e shtimit dhe përditësimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave dhe nevojave të stafit. <sup>210</sup> <b>GVJ këshillon që Biblioteka duhet gjithmonë të përpiqet për të pajisur fondin me literaturë të 5 viteve të fundit, për lëndët kryesore që mbulojnë Programet e studimit në UV.</b>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Rezultoni se bibliotekat në shërbim të stafit dhe studentëve funksionojnë me orare të përshtatura sipas funksionimit të orareve dhe veprimtarive mësimore shkencore. Biblioteka qendrore, p.sh. funksionon me orar të plotë 08.00-20.00, kurse bibliotekat e tjera me orar 08.00-16.00, të cilat janë në përshtatje edhe me oraret e studentëve. Biblioteka funksionon vetëm në orarin zyrtar normal të administratës, vetëm 5 ditë të javës, ora 08.00-16.00. <b>Nga përvoja jonë, Bibliotekat në IAL-të perëndimore, sidomos sallat e leximit kanë gjithmonë orar të zgjatur (ndonjëherë deri në 22.00), përfshirë edhe ditën e shtunë. Ka rëndësi ndjekja dhe dokumentimi nga Biblioteka, por dhe DB, si ka qënë përdorimi i fondit të Bibliotekës, por dhe i sallave nga personeli dhe studentët.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga kontaktet me stafin e administrimit të të dhënave si dhe nga dokumentacioni në dispozicion rezulton se informacioni në lidhje me studentët administrohet me një sistem të dyfishtë, pra nëpërmjet regjistrimit manual dhe atij elektronik. Kjo kryhet mbi bazën e rregullave të përcaktuara. I rëndësishëm është fakti i përdorimit të "Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UV" me akronimin UVMS (University of Vlora Management System). Sistemi përmban edhe elementë të tjerë të integruar në funksion të mësimin në distancë, si dhe krijon mundësinë e formimit të të ashtuquajturit portofol personal me të dhënat e secilit student. Të gjitha këto mendojmë se krijojnë kushte të


<sup>210</sup>Evidencalll.19 – Kërkesat buxhetore të DB-së. Evidencalll.26 –Informacion për Bibliotekën shkencore në UV.

*AS*

*[Signature]*

	administrimit integral të informacionit mbi studentët nga fillimi deri në mbarim të studimeve, si dhe lehtësojnë dukshëm menaxhimin e të dhënave. <sup>211</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Po kështu na rezulton se sistemi i menaxhimit të të dhënave administron me përpikmëri si dhe përditëson informacionin mbi veprimtaritë e gjithanshme të personelit të të gjitha kategorive. Ai është i gatshëm të sigurojë dhe të verë në dispozicion këtë informacion sa herë është e domosdoshme sipas procedurave të përcaktuara.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Personeli akademik, ai administrativ dhe ndihmës si dhe studentët kane akses të plotë në sistem ku mund të gjenden të gjitha të dhënat dhe informacionet në lidhje me elementët e programeve të studimit, oraret, procesverbalet e provimeve, si dhe informacione të tjera. Aksesit në Sistem është i siguruar përmes <i>username</i> dhe <i>password</i> për secilin përdorues.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit UVMS është interaktiv dhe si i tillë i lejon stafit akademik të komunikojë të gjitha informacionet e nevojshme me studentët, duke përfshirë materialet didaktike, vlerësimet etj. Nga ana tjetër, Sistemi lejon vlerësimin anonim nga studentët të zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu, mundëson edhe personelin ndihmës dhe Sekretarinë në përditësimin apo hedhjen e dokumentave të ndryshme korrente.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Me funksionet e tij Sistemi lehtëson në mënyrë të drejtpërdrejtë menaxhimin në kohë reale të të dhënave lidhur me gjithë veprimtarinë akademike dhe administrative të institucionit. Gjithashtu, me mënyrën e tij të funksionimit mundëson çdo lloj raportimi statistikor në kohë reale në lidhje me përmbajtjen e tij.
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë	Nga verifikimi ynë rezulton se i gjithë informacioni në lidhje me të gjitha veprimtaritë mësimore shkencore administrative, si dhe social kulturore që zhvillohen pranë institucionit dhe në përgjithësi pranë UVI pasqyrohen në faqen përkatëse të internetit. I gjithë informacioni publikohet në gjuhë shqipe dhe angleze.

<sup>211</sup>Evidenca III.24 -Vendim i Senatit, Nr. 101, datë 06.12.2017, Për krijimin dhe funksionimin në UV të Platformës Dixhitale. Evidenca III.25 –Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit në UV. Evidenca III.28 - Manuali përdorimit të e-learning. Evidenca III.29 -Shembull i një Llogarie UMS e një studentit: faqjakryesore, pikët e provimeve, e-learning. Evidenca III.27-Raport i Zyrës së IT-së: Shkresa nr.112/3, dt.20.01.2020.

ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				X

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit na rezulton se UVI përgatit në mënyrë periodike raportin financiar në ndjekje të gjithë veprimtarisë së gjithanshme të tij. Në këtë raport paraqiten të gjitha kostot duke filluar nga vlerësimet e programeve të studimit deri në nivelin e studentit. Hartimi i buxhetit bëhet sipas një rruge vertikale duke nisur nga njësia bazë deri në nivelet më të larta. UVI ndjek një politikë favorizuese për ato departamente që prodhojnë më shumë të ardhura.<sup>212</sup></p> <p>Nga Raporti Vjetor i UVI 2018-2019<sup>213</sup> vihet re se kostoja mesatare për student shkon mbi 1200 Euro/për student në vit (Buxheti i përgjithshëm 879,896,000 Lekë; Gjithsej studentë 5783), e cila tregon njëfarë përmirësimi krahasuar me pak vite më parë për IAL-të publike<sup>214</sup>. Për mendimin tonë <b>kjo gjendje financiare mbetet përsëri e ulët krahasuar me sistemin universitar, si atë privat në Shqipëri dhe sidomos për sistemin universitar në rajon dhe më gjerë. Kjo ndikon edhe në nivelin e përgjithshëm të pagave të personelit akademik dhe atij ndihmës, mesterisht të ulëta në rajon, në motivimin e personelit, si dhe në përditësimin e mjediseve laboratorike dhe të bibliotekës etj. Ka shumë rëndësi të gjenden rrugët dhe mundësitë për të shëndoshur gjendjen financiare në UVI dhe më gjerë në IAL-të e tjera publike.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe</p>	<p>DB harton në mënyrë të hollësishme planin e vet buxhetor në lidhje me kërkesat e zhvillimit të programeve mësimore dhe punës shkencore, të pasurimit të bibliotekës me literaturën përkatëse, si dhe për shpenzimet e tjera operative. Ai integrohet më pas në</p>

<sup>212</sup>Evidenca I-Raporti vjetor UV-së për vitin akademik 2017-2018 Evidenca J-Raporti vjetor UV-së për vitin akademik 2018-2019. Evidenca III.19 – Kërkesat buxhetore të DB-së. Evidenca IV.3 – Të dhëna për kostot e programit të studimit.

<sup>213</sup>Evidenca J- Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019.pdf: f. 135.

<sup>214</sup>Gjonçaj, 2015; f. 35; [https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport\\_Final\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf)

<p>teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>planin financiar të FSHTN dhe UVI. Vërejmë se ai është në përputhje me të gjitha specifikat e veprimtarisë së DB.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Konstatohet se institucioni në përgjithësi, në zbatim të ligjeve të përcaktuara realizon audit financiar të brendshëm dhe të jashtëm, i cili kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MASR. Nga dokumentacioni na rezulton se në raportet përmbahen të dhëna të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit apo kontribute të tjera.</p> <p>Në këtë kuadër na rezulton, p.sh. se gjatë vitit akademik 2018-2019, Sektori i Auditit të Brendshëm ka realizuar 3 auditime gjatë të cilave ka lënë dhe rekomandimet përkatëse, të cilat janë dhe pjesë integrale e Raportit vjetor për vitin akademik 2018-2019.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe plani fikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Me mbylljen e cikleve të plota të studimit kryhet analiza financiare në lidhje me vitet e kaluara. Analiza synon gjithashtu mundësitë e ndërhyrjeve në raste të veçanta për përmirësimin e financimit, gjë e cila ndihmon në garantimin e ecurive dhe mbarëvajtjes normale. Raporte të tilla ruhen të protokolluara në arkivën e institucionit. Këto iu komunikuan GVJ në takimet me stafin akademik dhe administrativ.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Mbështetur në të dhënat e raporteve financiare, si u tregua edhe më sipër, rezulton se institucioni ka qëndrueshmëri financiare për mbështetjen e programeve të studimit si dhe kapacitetet e nevojshme për përmirësim të mëtejshme. Megjithatë, <b>GVJ vëren se duhen bërë më shumë përpjekje për rritjen e kapaciteteve financiare përmes rritjes së mbështetjes nga Qeveria, shtimit të numrit të studentëve dhe rrjedhimisht kontributit me tarifat e tyre, si dhe përmes gjetjeve të rrugëve të reja për të ofruar shërbime ndaj të tretëve.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

*Alvord*

*Shimur*

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, nga kontaktet me stafin akademik si dhe me studentetë rezulton se politikat e hartuara nga institucioni janë të mbështetura në ligjshmërinë përkatëse në fuqi. Informacioni i përgatitur nga DB në lidhje me kërkesat dhe kriteret e pranimit është i plotë dhe në dispozicion të kandidatëve për studentë. Pas pranimit studentëve u vihen në dispozicion të gjitha lehtësirat dhe mundësitë që ofron sistemi. Në rregulloret e institucionit paraqiten me hollësi të gjitha rregullat dhe udhëzimet përkatëse për ecurinë e studimeve, si dhe për përmbylljen e tyre me provimin përfundimtar apo me punim diplome. <sup>215</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Informacioni që UVI ju ve në dispozicion studentëve përpara hyrjes në universitet, si dhe përmbajtja e rregulloreve dhe udhëzimeve të veçanta gjatë zhvillimit të ciklit të studimeve garantojnë trajtimin e barabartë të studentëve <sup>216</sup> . Atyre u ofrohen të njëjta të drejta në të gjitha llojet e shërbimeve që ve në dispozicion institucioni. Studimet pranë këtij institucioni mund të ndiqen me kushte të barabarta edhe nga studentë të huaj apo etni të tjera, nga individë me aftësi ndryshe etj., sipas përcaktimeve në rregullore. Një informacion i tillë iu konfirmua GVJ jo vetëm nga dokumentacioni i shqyrtuar, por edhe nga takimet <i>online</i> me studentët.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë	Të gjitha kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, si dhe ato të ecurisë së vlerësimit gjatë procesit mësimor, janë të përcaktuara dhe të shpjeguara qartë në rregulloret e FSHTN dhe të DB. Ato janë të qarta edhe në lidhje me elementë të tjerë që kanë të bëjnë me njohjen e studimeve të mëparshme apo transferimeve në institucione të tjera. Të gjitha janë në dispozicion dhe lehtësisht të aksesueshme jo vetëm nga studentët, por edhe nga publiku i interesuar.

<sup>215</sup>Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelornë "Biologji", Kreull, Neni 5. Evidenca III.40 – Rregullore e Diplomimit. Evidenca II.16 –Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji" në DB. Evidenca III.44 – Format i Diplomës Bachelor në "Biologji". Evidenca II.3 – Suplementi i Diplomës Bachelor në "Biologji". Evidenca I.2 –Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreull, Neni15  
<sup>216</sup>Evidenca I.15- Procedurë miratimi kuotash në DB. Evidenca I.16-Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e Studimit Bachelor në "Biologji". Evidenca II.25 – Mobilitet student.pdf.

*Alid*

*Armani*



lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Rezulton se për çdo vit DB analizon mundësitë dhe propozon kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve. Të gjitha këto konstatohet se paraqiten dhe shpjegohen qartë në rregulloret në dispozicion. <b>GVJ sugjeron që të bëhet më shumë përpjekje për tërheqjen e një numri më të madh studentësh, duke u nisur nga numri i ulët i tyre për vitin akademik 2020-2021.</b>  Këtu ka rëndësi që edhe MASR të bëjë gjithmonë të ditur se sa janë nevojat në vend për të diplomuar në secilën diplomë të miratuar nga MASR, dhe mundësisht të bëjë shpërndarje proporcionale të këtyre kuotave mes IAL-ve që zhvillojnë këto diploma.								
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga kontaktet me personelin akademik rezulton se kriteret e pranimit në UVI ndërtohen duke ndjekur udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse nga Këshilli i Ministrave apo MASR për çdo vit akademik. Gjithashtu, kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në rregulloret e veçanta janë në përputhje me aktet dhe udhëzimet e MASR për arsimin dhe maturën shtetërore.								
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik UVI organizon punë përgatitore për informimin e publikut të interesuar në lidhje me programet dhe cilësitë që ofrohen, drejtimit e studimit si dhe kriteret dhe rregullat e pranimit. Në këtë kuadër veprimtari të koordinuara dhe të kombinuara me njësitë përkatëse apo edhe me institucione të tjera vendore. <sup>217</sup>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në	Informacionet në lidhje me procedurat e ecures së përparimit të studentëve, kriteret e vlerësimit etj, parashikohen me rregullsi në disa dokumenta, rregullore apo dhe në vetë programet e studimit, të cilat

<sup>217</sup>Evidenca V.2 –Aktivitete për informimin e maturanëve. Evidenca V.1 -Fletë-palosja dhe Guida e Studentit, DB 2019-2020. Evidenca V.3 –Aktiviteti “Open Day”. Evidenca III.34 - Relacion mbi pjesëmarrjen në “Panairin e Punës 2019”, orientim për tregun e punës. One TV Vlora. Speciale-Panairi Rajonal i Punës.

lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	studentëve u vihen në dispozicion. Po kështu sistemi elektronik UVMS është efikas në dhënie të një informacioni të tillë. Gjithashtu, në këtë kuptim përdoren me sukses edhe elementë të tjerë lehtësisht të aksesueshëm nga studentët, si faqja FB eDB, stenda të ndryshme etj. <sup>218</sup>				
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Si u theksua edhe më lart, i gjithë sistemi i informimit i organizuar nga UVI lejon informimin e tyre në lidhje me të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me kriteret mbi njohjen e kualifikimeve apo studimeve të kryera më parë, qofshin këto edhe të pjesore. Si rregull, ato prezantohen edhe nga pedagogët në procesin e fillimit të çdo lënde mësimore.				
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët informohen në lidhje me kriteret e vlerësimit të dijeve të përfituara si dhe me procedurat përkatëse, përmes rregullores së studimeve si dhe përmes vetë syllabusit të lëndës përkatëse. Të gjithë këta elementë janë në dispozicion dhe mund të merren pranë Sekretarisë mësimore. <sup>219</sup>				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rezulton se procedurat lidhur me procesin e diplomimit janë të përcaktuara qartë në rregulloret e përgjithshme të UVI, të DB dhe më pas në rregulloret e Programit të studimit dhe të diplomimit. I gjithë procesi kryhet në bashkëpunim me gjithë informacionin që furnizohet nga Sekretaria mësimore. Janë të përcaktuara qartë kriteret për punimin e diplomës, si duhet punuar, dorëzuar dhe mbrojtur para Komisionit, dhe të gjitha këto informacione i komunikohen studentëve nëpërmjet stafit administrativ dhe atij akademik (Udhëheqësi i Diplomës). <sup>220</sup>				
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Si është theksuar edhe më parë, UVI organizon punë parapërgatitore dhe periodike në fillim të çdo viti akademik. Rol të rëndësishëm në këtë proces luajnë bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore në Vlorë, apo edhe me strukturat e veçanta të institucionit, si Sektori i Këshillimit dhe Karrierës, ai i Alumni etj. Edhe një herë këtu tërhiqet vëmendja që <b>i gjithë ky proces duhet të shoqërohet me efektivitet më të lartë për tërheqjen e një numri më të madh studentësh.</b>				
	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

<sup>218</sup>Evidenca II.13 –Relacion drejtuar Drejtuesit të Njesisë Bazë nga koordinatori për marrëdhëniet me studentin. Faqja e Facebook: Departamenti Biologjisë:

<https://www.facebook.com/Departamenti-i-Biologjise-FSHT-Vlore-152327005687991/> . Evidenca II.11 –

Riorganizimi i grupeve mësimore në DB. Evidenca III.31- Manuali i përdorimit të UMS për studentët:

[https://uvms.univlora.edu.al/media/MANUAL\\_PERDORIMI\\_UVMS.pdf](https://uvms.univlora.edu.al/media/MANUAL_PERDORIMI_UVMS.pdf). Evidenca II.22-Kalendari Akademik:

<https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/kalendari-UV-2018-2019.pdf>.

<sup>219</sup>Evidenca V.4-Relacion i prezantimit me studentët, në DB, në fillim të vitit akademik. Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Biologji”, Kreu III, Nenet 9-14. Evidenca II.1 –Syllabuset lëndore. Evidenca II.16 –Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në “Biologji” në DB. Evidenca C-Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VIII, Neni 65. Evidenca I.2-Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreu II, Neni 19.

<sup>220</sup>Evidenca III.40 –Rregullore e Diplomimit. Vendim SA, Nr. 09, date 26.01.2017. Evidenca II.16 –Procedura e diplomimit në Programin e Studimit Bachelor në “Biologji” në DB.

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët ndjehen të informuar në lidhje me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen dhe hollësi të tjera të programit të studimit. Këto informacione paraqiten me hollësi në programet apo modulet e lëndëve si dhe në faqen zyrtare të universitetit. Rol të rëndësishëm ka edhe koordinatori i DB, i cili është në kontakt të përhershëm me studentët. Ky informacion u konfirmua edhe nga takimet <i>online</i> me grupe të ndryshme studentësh.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga takimet dhe intervistat me studentët si dhe nga dokumentat e shqyrtuara u konstatua se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dokumentacion të bollshëm për informimin në lidhje me përmbajtjen e moduleve apo lëndëve dhe veprimtarive të tjera formuese. <sup>221</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni organizon dhe jep informacione të vazhdueshme në lidhje me mundësitë e punësimit apo orientime për tregun e punës. Një nga rrugët është ajo e ftesës që u bëhet studentëve për të ndjekur panairin e karrierës apo veprimtari të tjera të ngjashme. <sup>222</sup> Gjithsesi ajo që bie në sy është <b>pjesmarrja ende e ulët e studentëve dhe një farë mosbesimi në vlerat e informacioneve të tilla.</b>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë intervistave me studentët na u krijua bindja se ata janë plotësisht të informuar nga institucioni në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor, me logjistikën në përdorim, si dhe mbi hollësi të tjera si orari; sallat janë të etiketuara me numra, të cilat përputhen me informacionin në orar; zyrat e pedagogëve, stafit administrativ, gjithashtu, kishin numrat dhe emrat përkatës etj. Informacione të tilla studentët mund t'i gjejnë lehtësisht edhe në faqet e përditësuara të internetit

<sup>221</sup>Evidenca A-Statuti i UV-së, Kreu VII, Neni 77: <https://univlora.edu.al/statuti/>. Evidenca II.14-Rregullore e FSHT-së, Kreu V, Neni 16. Evidenca C-Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu IX, Neni 71. Evidenca I.2-Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreu II, Nenet 15, 16, 17. Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu IV, Nenet 19,20, 21. Evidenca V.4 -Relacioni prezantimit me studentët, në DB, në fillim të vitit akademik.

<sup>222</sup>Evidenca III.34 –Relacion mbi pjesëmarrjen në "Panairin e Punës 2019", orientim për tregun e punës. Evidenca I.22- Marrëveshjet bashkëpunuese të DB-së me Institucione të tjera.

*ASCB*

*Armin*

<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm i institucionit siguron informacion të mjaftueshëm për studentët, të cilëve u është vënë në dispozicion llogaria personale. Në kushtet e krijuara nga Covid 19 sistemi <i>online</i> ka funksionuar për zhvillimin e mësimave nëpërmjet Platforms Google Classroom.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Nga kontaktet me punonjësit e Drejtorisë së Edukimit, si dhe me punonjës të Sekretarisë mësimore rezultojnë se institucioni mban dhe administron statistika të plota për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga vizitat virtuale pranë Sekretarisë së institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës u vu re se disponohen statistika të rregullta vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në ciklin e parë, tërheqet nga programet apo edhe largimet para përfundimit dhe mospërfundimin e vitit akademik. Sekretariteti përkatës të departamentit dhe të Njësisë kryesore administrojnë informacionin përmes dokumentave si: Regjistri themeltar i studentëve; Regjistri i arritjeve akademike; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. Informacione të tilla ruhen me shkrim dhe në mënyrë elektronike në përputhje me rregullat dhe janë konfidenciale. <sup>223</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që	Të dhënat e mësipërme (kriteri 2) dëshmojnë gjithashtu se UV1 disponon përmes një dokumentacioni të saktë dhe të mirë menaxhuar për ecurinë e studentëve gjatë gjithë kohës nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

<sup>223</sup>Evidenca V.6- Manuale të përdorimit të Google Classroom dhe të dhëna të përdorimit në DB. Evidenca V.7 – Të dhëna për diplomimet e studentëve nga Drejtoria e Edukimit. Evidenca I-Raporti vjetori UV-së për vitin akademik 2017-2018, f. 104-114. Evidenca J-Raporti vjetori UV-së për vitin akademik 2018-2019, f.100-101; 122-136.

nga pranimi deri në diplomimin e tyre.									
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Si rezultoi nga analizat dhe kontaktet me personelin, sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit UVMS është në shërbim edhe të menxhimit të të dhënave statistikore. Mënyra e tij e organizimit siguron konfidencialitetin dhe shpejtësinë e përdorimit të të dhënave. Sektori i IT ofron mundësitë e përdorimit nga përdoruesit si dhe garanton sigurinë e funksionimit të të dhënave sipas ligjeve në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale<sup>224</sup>.</p> <p><b>Megjithatë, nga intervistat me Sekretarinë mësimore GVJ konstaton se nuk ka të dokumentuara auditime të brendshme të saktësisë së përputhjes së informacionit të vlerësimeve nëpërmjet procesverbaleve të personelit akademik me ato të Regjistrisë themeltar dhe sistemit elektronik UVMS. Këshillojmë që Institucioni të sanksionojë në Rregulloret përkatëse mënyrën e sigurisë/saktësisë së ruajtjes së sistemit të vlerësimit (notave), dhe parandalimin e gabimeve qoftë edhe njerëzore, dhe promovimin për auditimet me saktësi të lartë.</b></p>								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Nga kontaktet me personelin si dhe nga RVB rezulton se institucioni harton rregullisht raporte analitike lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në mbarim të ciklit të studimeve. Raportet hartohen në përputhje me informacionin dhe evidencat e përfuara nga FShTN dhe DB.</p> <p><b>GVJ vlerëson se gjurmimi i punësimit të studentëve duhet të jetë më i plotë dhe i vazhduar për të krijuar një ide më të plotë që ndihmon në përgatitjen më të mirë të strategjive dhe përshtatjes së programeve mësimore në përputhje me kërkesat e tregut të punës</b></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve	Nga shqyrtimi i dokumentave si dhe nga kontaktet virtuale me studentët, GVJ vlerëson se studentët janë të përfshirë me përfaqësuesit e tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Kjo e drejtë e tyre garantohet edhe nga ligji dhe statuti i UV. Këshillat studentore janë funksionale në

<sup>224</sup>Ligji Nr.9887, datë 10.03.20008, ndryshuar meligjin Nr. 48/ 2012, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	nivel të FShTN dhe DB. Ata zgjidhen përmes një procesi të menaxhuar nga komisionet përkatëse zgjedhore. <sup>225</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Konstatohet se institucioni ka siguruar pjesëmarrjen e studentëve me përfaqësuesit e zgjedhur të tyre në proceset e vendimmarrjes, këshillimit apo vlerësimeve të procesit akademik. Rezultoni se janë 2 studentë përfaqësues në Senatin Akademik. Ata janë të përfaqësuar gjithashtu në Komisionet e përheshme të vlerësimit të cilësisë në rang Njësie kryesore; janë të përfaqësuar në komisionet <i>ad-hoc</i> për sigurimin e cilësisë etj. <sup>226</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoni se hartimi dhe përmirësimi i Programit të studimit është kryer mbi bazën e vendimeve dhe udhëzimeve në fuqi (VKM 41/2018). Institucioni ka marrë parasysh ngarkesën e studentëve në hartimin e programeve të studimit, gjithashtu edhe ndryshimet dhe përmirësimet janë sipas ndryshimeve ligjore. Në lidhje me procedurat e përparimit të studentëve është ngritur Komisioni për “Ekuivalentimin dhe Vlerësimin për Transferim”, i cili është i angazhuar në këtë proces. <sup>227</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Sipas statutit dhe rregullores së UVI, studentëve u jepet mundësia dhe garancia e përfshirjes në të gjitha hapat e procesit të hartimit apo përmirësimin të programeve, veçanërisht përmes përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese. Nga ana tjetër, përmes pyetësorëve mund të sugjerojnë ndryshimet përkatëse dhe vërejtjet e tyre për programet apo modulet e ndryshme mësimore. <sup>228</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe	Statuti dhe rregullorja e UVI parashikojnë garancitë e lirisë së shprehjes së mendimit mbi proceset e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Gjithashtu, përmes intervistave <i>online</i> , studentët pohuan se atyre u jepet

<sup>225</sup>Ligji Nr. 80/2015, Kreu IX, Neni 99. Evidenca A-Statuti i UV-së, Kreu VII, Neni 74. Senati Akademik/Senatorët.

<sup>226</sup>Evidenca V.9 –Urdhër mbi ngritjen e grupit të punës për pilotimin e pyetësorit të shërbimeve mbështetëse. Evidenca III.32 –Informacioni i NJSBCVI-së, shkresë Nr. 1778 Prot., date 24.12.2019. Evidenca V.9 –Urdhër mbi ngritjen e grupit të punës për pilotimin e pyetësorit të shërbimeve mbështetëse. Evidenca V.8 -Urdhëri Rektorit Nr. 123, date 19.12.2019., Evidenca V.10 –Studentë të angazhuar në grupin e punës mbi sondazhin kombëtar të studentëve.

<sup>227</sup>Evidenca I.6-Programi Mësimori Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Biologji”. Evidenca I.12- Procedurë ekuivalentimi dhe transferimi studimesh në DB. Evidenca II.25 – Mobilitet studentit.

<sup>228</sup>Evidenca L-Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019. Evidenca III.32 – Informacioni i NJSBCVI-së, shkresë Nr. 1778 Prot., date 24.12.2019. Tabelat Përmbledhëse të aneksit të RVB-së, Tabela 24. Evidenca K-Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018. Evidenca III.5 - Kthim përgjigje I DB-së në lidhje me raportin e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2018-2019, Shkresë, Nr. 138/2 Prot., datë 04.03.2020.

ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	dhe u është garantuar mundësia e shprehjes në lidhje jo vetëm me procesin mësimor, por edhe për çështje të etikës në sjellje dhe komunikim, të ankimimit të rezultatit të provimit etj. Nga studentët u pohua se gjithmonë kanë pasur reagimin e duhur institucional ndaj kërkesave, sugjerimeve apo shqetësimeve të tyre. <sup>229</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				<b>X</b>

### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Në lidhje me shërbimin e informimit, pranë institucionit funksionojnë njësi të posaçme si: Drejtoria e edukimit për të dy ciklet, me dy sektorë, atë të Kurrikulave dhe sektorin e Këshillimit të karrierës. Ndërkohë, në këtë funksion janë të përfshirë Sekretaritet mësimore dhe Koordinatorët për marrëdhëniet me studentët. Funksionimi dhe procedurat që ndjekin këto njësi janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UVI. <sup>230</sup> Të gjitha këto garantojnë informim të plotë të studentëve, të cilën ata e pohuan edhe gjatë takimeve <i>online</i> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nga takimet <i>online</i> me strukturat administrative, si dhe nga takimet me studentët, rezultojnë se informimi, këshillimi dhe ndjekja e përparimit të studentëve gjatë procesit mësimor kryhet përmes një sistemi funksional, i cili gjithashtu përfshin Sekretarinë mësimore, Sektorin e kurrikulave dhe shërbimit të studentëve, Koordinatorin e studentëve, Sektorin e karrierës veprimtarive sportive etj. Edhe nga studentët u pohua kryerja me korrektësi e detyrave nga kjo pjesë e sistemit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin	Sektorin e këshillimit të karrierës, alumni dhe veprimtarive kulturore është funksional pranë UVI, i cili furnizon studentët me informacione të përshtatshme në lidhje me tregun e punës

<sup>229</sup>Evidenca A-Statuti I UV-së, Kreu VIII, Neni 82, pika 7. Evidenca C-Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VII, Neni 62. Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji", Kreu III, Nenet 10, 11. Raport RVB-Departamenti i Biologjisë-Maj 2020 PDF.pdf, Tabela24.

<sup>230</sup>Evidenca III.33-Struktura e UV-së 2019. (Vendim SA, Nr. 12, date 27.02.2019, "Drejtoria e Edukimit për Ciklin I dhe II). <https://univlora.edu.al/sektorit-i-keshillimit-te-studenteve-dhe-alumn-i/>. Evidenca I.2-Rregullore e Departamentit të Biologjisë, Kreu III, Neni 2; Evidenca C-Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu V, Neni 54. Evidenca A - Statutit UV-së, Kreu VIII, Neni 77.

e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	dhe shërben për të krijuar kontakte dhe bashkëpunim me punëdhënësit potencialë vendorë apo më tej, si dhe me orientimet e nevojshme për kryerjen e praktikave profesionale. Ndërkohë, si konstatohet edhe nga GVB, specialistët e Zyrës së shërbimeve ndaj studentëve janë të angazhuar në organizimin edhe të të gjitha veprimtarive të tjera kulturore dhe artistike në shërbim të plotësimit të procesit mësimor.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Rezulton se janë bërë përpjekje të vazhdueshme përmes Sektorit të këshillimit të karrierës, alumni dhe aktiviteteve kulturore dhe sportive për të gjurmuar ecurinë e punësimit të studentëve që përfundojnë procesin mësimor. Për këtë hartohen raporte periodike. Për të ruajtur sa më mirë kontaktet, në faqen e UVI ka një seksion të veçantë me një databazë modeste për Alumni; gjithashtu është vënë në dispozicion edhe nje formular përkatës. <b>Sidoqoftë, GVJ vëren se plotësimi i formularit ende kryhet nga një numër i kufizuar studentësh.</b> <sup>231</sup>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në lidhje me Sigurimin e Brendshëm të cilësisë institucioni ka hartuar politikat dhe ka ngritur strukturat përkatëse duke organizuar një sistem funksional dhe efektiv. Të gjitha këto janë të dokumentuara (si tregohet më poshtë) në Statut, Rregullore dhe Planet e veçanta strategjike, si dhe përmes vendimeve periodike. Ndërkohë përmes anketimeve të

<sup>231</sup>Evidenca J-Raporti vjetor i UV-së për vitin akademik 2018-2019, fq. 118-120. <https://univlora.edu.al/alumni/>

*Handwritten signature*

*Handwritten signature*



	vazhdueshme nga studentët plotësohen pjesë të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. <sup>232</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Përmes përcaktimeve në Planin Strategjik (të cituar më sipër) konstatojmë rëndësinë që i ka kushtuar institucioni Sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë duke kryer edhe riorganizime periodike të strukturave. Ndërkohë, është në miratim e sipër Rregullorja përsigurimin e brendshëm të cilësisë në UVI.<sup>233</sup></p> <p>GVJ duke u mbështetur edhe në analizën e GVB vëren se ende nuk janë miratuar plotësuar dhe vënë plotësisht në funksion Komisionetepërhershëm të sigurimit të cilësisë përçdo njësi Kryesoredhe në nivelInstitucioni.<sup>234</sup> <b>Këshillohet përdorimi i treguesve më të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, përfshirë dhe shikueshmërinë e veprimtarisë në rrjetet shkencore ndërkombëtare dhe institucionalizimi në Rregulloren e UVI, dhe Rregulloret e tjera në varësi (Standrdi I.5, Kriteri 3). Kjo do të pasqyronte më mirë gjendjen, arritjet, por dhe do të nxiste për më shumë.</b></p> <p>Nga ana tjetër, rezulton se studentët janë pjesë aktive e këtij procesi nëpërmjet plotësimit të formularëve të vlerësimit, diskutimit në forumet përkatëse apo anketimve të ndryshme.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Nga dokumentacioni në dispozicion si dhe nga RVB rezulton se UVI i është nënshtruar akreditimit institucional qysh në Maj 2017 për një periudhë prej tre vitesh akademike. Institucioni ka përgatitur një plan të veçantë veprimi për të plotësuar vërejtjet, rekomandimet apo mangësitë të vlerësuar gjatë këtij procesi. Gjithashtu, rezulton nga RVB se institucioni i është nënshtruar në muajt Prill-Maj 2019 edhe vlerësimit nëpërmjet Sondazhit kombëtar të studentëve, rezultatet e të cilit priten të dalin së shpejti, dhe të bëhen publike prej ASCAL. Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë DB organizon analiza periodike dhe krahasuese, të cilat paraqiten në raportet e punës vjetore. <sup>235</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që	Institucioni ka hartuar dhe ndjek politika të qarta për procesin e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve studimore. Përmes NJSBCVI me anë të procedurave të përcaktuara kryhen analiza periodike duke përfshirë këtu edhe pyetësorët e studentëve para dhe pas provimeve. Me vendim të Senatit analizat shoqërohen me rekomandime

<sup>232</sup>Ligji Nr.80/2015, Kreu X, Neni 103, pika1. Evidenca A-Statuti i UV-së, Kreu VIII, Neni, 22, pika 2 dhe 3; Nenet 80-82. Evidenca B- Plani Strategjik 2018-2024 I UV-së, Pika VII. Objektivat Strategjike, f. 36-40. Evidenca C- Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu X, Neni 84. Evidenca III.3- Vendimi SA, Nr. 21, date 08.05.2018.

<sup>233</sup>Evidenca III.32 –Informacioni i NJSBCVI-së, Shkresë Nr. 1778 Prot., date 24.12.2019. Evidenca A-Statuti i UV-së, Kreu VIII, Neni 82.

<sup>234</sup>Evidenca VI.3 -Draft rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në UV.

<sup>235</sup>Evidenca VI.6 –Informacion për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga BA. Evidenca I.19-Raporti vjetor i punës mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore në DB, Janar 2018- Shtator 2019.

ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	për korigjimin e mangësive të konstatuara. <sup>236</sup> Të gjitha këto janë në shërbim të synimeve për të krijuar kulturën e nevojshme të cilësisë në rang institucional dhe të njësive të tjera përbërëse.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Nga dokumentacioni dhe RVB rezulton se institucioni ka ngritur njësi të veçanta për proceset e monitorimit, mbikëqyrjes apo rishikimit të programeve të studimit të ciklit të parë. Në këtë kuadër funksionojnë strukturat, si Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë, me Sektorin e kurrikulave dhe shërbimit ndaj studentit. Si është përmendur dhe më parë është në funksion në nivel institucioni Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimit institucional (NJSBCVI); po kështu rezulton se janë parashikuar ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të sigurimit të cilësisë së brendshme (KSBCI) dhe (KSCBF). <sup>237</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Në lidhje me shqyrtimet, miratimet apo mbikëqyrjen e programeve të studimit rezulton se institucioni përdor si mekanizma periodike analizat dhe raportet vjetore në Njësinë kryesore dhe atë bazë, si dhe rezultatet e përfuara nga pyetësorët e studentëve. <sup>238</sup>

<sup>236</sup>Evidenca A-Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, Kreu VIII, Nenet 80-82. Evidenca C-Rregullore e UV-se e ndryshuar, Kreu X, Neni 86. Evidenca III.3-Vendim SA, Nr. 21, date 08.05.2018, Procedurë e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Evidenca VI.7 -Formulari i pyetësorit të studentëve, realizuar nga NJSBCVI.

<sup>237</sup>Evidenca III.32 –Informacioni i NJSBCVI-së, Shkresë Nr. 1778 Prot., date 24.12.2019. Evidenca A-Statuti i UV-së, Kreu III, Neni 22.

<sup>238</sup>Evidenca II.8 -Vendim SA, Nr. 51 dhe Nr. 52, date 31.10.2016. Evidenca III.5-Kthim përgjigje i DB-së në lidhje me raportin e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2018-2019, Shkresë, Nr. 138/2 Prot., datë 04.03.2020.



*Alida*

*Alida*

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Në funksion të punës vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e Programit të studimit UVI ve në lëvizje sektorët si Dega e zhvillimit të kurrikulave, karrierës dhe vlerësimit institucional dhe Dega e informacionit dhe transferimit të njohurive. Këta sektorë vlerësojnë me parametra të matshëm ecurinë e Programit. Nga ana tjetër, analizat periodike të mbarëvajtjes së programeve kryhen mbi bazën e disa elementëve të matshëm dhe që furnizohen edhe nga Sekretaria mësimore. Nërkojë është përdorur për herë të parë edhe Pyetësi i Studentëve për vlerësimin e cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademik dhe administrativ.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit si dhe intervistave <i>online</i> me personelin dhe studentët rezultoi se rezultatet e vlerësimeve jo vetëm që dokumentohen, por u bëhen të njohura personelit si dhe autoriteve vendimmarrëse në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Sipas RVB dhe nga dokumentacioni vlerësojmë se raportet e vlerësimit përfshijnë realisht rezultatet dhe masat e propozuara për përmirësimin e mangësive të konstatuara. Raporte të tilla janë të dokumentuara.<sup>239</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.3</b></p>	
<p><b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<sup>239</sup>Evidenca III.3-Vendim SA, Nr.21, date 08.05.2018, Procedurë e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të Studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Evidenca VI.8-Mbledhje Departamenti (Analizë e rezultateve të pyetësorit). Evidenca III.5-Kthim përgjigje i DB-së në lidhje me raportin e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2018-2019, Shkresë, Nr. 138/2 Prot., datë 04.03.2020.

<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Rezultoni se nga Njësia e brendshme e vlerësimit procesi i vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit bëhet në mënyrë periodike. Kjo ka shërbyer në formimin e kulturës së vlerësimit dhe analizës kritike. Vlerësime të tilla ashtu si dhe analiza të tjera janë të dokumentuara (si më poshtë)<sup>240</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga kontaktet me personelin, si dhe nga RVB, rezultoni se NJSBCVI përdor dhe përmirëson metodat dhe instrumentet e procesit të vlerësimit të cilësisë. Veprimtaria pasqyrohet dhe dokumentohet ne Raportin vjetor në fund të vitit akademik. Instrumentet dhe metodat përfshijnë vlerësimet përmes pyetësorëve të studentëve, të dhënat nga Sekretaria mësimore, seminarët informuese dhe trajnuese etj.<sup>241</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe kontaktet me personelin akademik rezultoni se në kuadrin e vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së Programit të studimit, në fillim të vitit akademik drejtuesi i DB rikontrollon dhe rivlerëson përmbajtjen e syllabuseve mbi bazën e vërejtjeve dhe analizave të mëparshme. Nga ana tjetër, përmes parametrave të matshëm në disa elementë vlerëson mbarëvajtjen e çdo lënde.<sup>242</sup></p> <p>GVJ vëren se duhet bërë më shumë në përmirësimin e metodave dhe rrugëve të vlerësimit. Përmirësimi i cilësisë së performancës së gjithë personelit do ndihmojë edhe në tërheqjen e sa më shumë studentëve cilësorë. <b>Mendojmë se edhe Raportet mund të strukturohen më mirë, sidomos me arritjet në kërkim (Standardi I.5, Kriteri 3), për të shmangur përsëritje në tituj publikimesh, apo pjesëmarrje në ngjarje të ndryshme kërkimore. Por ajo që është më e rëndësishme, janë përdorimi i treguesve më të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, edhe të institucionalizuar në Rregulloren e UVi, dhe Rregulloret e tjera në varësi. Mbi bazën e treguesve cilësorë të matshëm në kërkim dhe mësimdhënie, institucioni mund të bëjë edhe promovime nxitëse për arritjet më të mira.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor</p>	<p>Përveç informacioneve të mbledhura përmes pyetësorëve në lidhje me vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë për programet mësimore, institucioni ka bërë përpjekje për</p>

<sup>240</sup>Evidenca VI.11-Raporti i Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të DB-së 2012-2019. Evidenca III.8 – Performancë stafi akademik, e plotësuar nga drejtuesja e DB-së sipas formatit të miratuar nga SA, me Vendim Nr. 52, date 20.04.2017. Evidenca II.26-Literatura e miratuar në DB, në 4 vitet e fundit.

<sup>241</sup>Evidenca V.8 –Urdhër i Rektorit Nr.123, date 19.12.2019. Evidenca J-Raporti vjetor i UV-së për vitin akademik 2018-2019. Evidenca L-Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019.

<sup>242</sup>Evidenca VI.12-Mbledhje departamenti (syllabuse, literature). Evidenca I.19-Raporti vjetor i punës mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore në DB, Janar 2018- Shtator 2019.

<p>metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>marrjen e informacioneve edhe nga bashkëpunëtorë të jashtë, ish studentë apo institucione të tjera publike dhe private. Gjithsesi GVJ vëren se <b>ende mungojnë instrumenta të mirëorganizuar për tërheqjen më të plotë e të specializuar të institucioneve apo bashkëpunëtorëve të tjerë.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Në përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se institucioni ka parashikuar politika dhe procedura të brendshme për përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në sigurimin e cilësisë. Këto janë parashikura në Statutin dhe Rregulloren e UVJ, si dhe në vendime të posaçme të Senatit.<sup>243</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në dokumentacionin përkatës (dokumentat tek kriteri 1) përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për të gjithë individët dhe strukturat përbërëse të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Detyrat e përcaktuara garantojnë ecurinë dhe ushtrimin me përgjegjësi të funksioneve të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga kontaktet <i>online</i> me personelin akademik si dhe nga RVB rezulton se përfshirja e DB në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së Programit ende nuk është garantuar sepse pritet ngritja në nivel Fakulteti e Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme. Ky rol kryhet për momentin nga Dekanati, i cili orienton dhe mbështet politikat e fakultetit në drejtim të sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Vemendje e veçantë në këtë drejtim i është kushtuar</p>

<sup>243</sup>Evidenca A-Statuti i UV-së, Kreu VIII, Neni 81, 82, 83. Evidenca C-Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu X, Neni 86. Evidenca B- Plani Strategjik 2018-2024 i UV-së, VII. Objektivat strategjike, f. 36-40.




	<p>pjesmarrjes së studentëve përmes anketimeve tëNJSBCVI, Këshillit studentor.si dhe angazhimit të tyre nëgrupe të posaçme për vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore.</p> <p><b>GVJ sugjeron ngritjen e menjëhershme të Komisioneve në nivel fakulteti për të garantuar më mirë sigurimin e cilësisë së Programit dhe përfshirjen e DB në të.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion si dhe nga RVB rezulton se gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë së programeve, përfshirja e aktorëve të niveleve të ndryshme është kryer në respekt të lirisë dhe etikës akademike, si dhe në përputhje me ruajtjen dhe respektimin e integritetit, konfidencialitetit bazuar në Ligjin 9887/2008, ndryshuar me Ligjin 48/2012, Për mbrojtjen e të dhënave personale.<sup>244</sup></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga raporti i GVB si dhe nga dokumentacioni i institucionit konstatohet se bëhen përpjekje për përfshirjen edhe të bashkëpunëtorëve apo institucioneve të tjera të jashtme të interesuara në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.<sup>245</sup> Gjithsesi, GVJ vlerëson se më shumë përpjekje dhe më shumë veprimtari duhen bërë në këtë drejtim. <b>Mendojmë se në Vlorë ka më shumë mundësi për bashkëpunime lidhur me mbarëvajtjen e Programit</b> dhe të Masterave që rrjedhin prej tij (Standardi I.5., Kriteri 4).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga kontaktet online me stafin dhe grupe të studentëve si dhe nga RVB rezulton se politikat e ndjekura, strategjitë dhe veprimtaritë e tjera në kuadrin e procesit të Sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë bërë në kushte të transparencës publike dhe të dokumentuara.</p>

<sup>244</sup>EvidencaIII.32 –Informacionii NJSBCVI-së,shkresëNr.1778Prot., date 24.12.2019.

<sup>245</sup>Workshopi“Studentët dheregui punës”:<https://univlora.edu.al/2019/12/22/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/>.

<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në procesin e veprimtarive për sigurimin e brendshëm të cilësisë, rezultatet e vlerësimeve publikohen duke respektuar rregullat mbi lirinë dhe etikën akademike, si dhe Ligjin 9887/2008, ndryshuar me Ligjin 48/2012, Për mbrojtjen e të dhënave personale. <sup>246</sup>			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në kontaktet me stafin akademik dhe me përfaqësues nga Dekanati rezultoi se për problemet që hasen gjatë procesit të vlerësimit përpilohen plane masash me qëllim zgjidhjen e tyre.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në këtë kuadër një nga masat më të rëndësishme që ka ndërmarrë institucioni rezultoi të jetë ngritja e grupit të punës, në nivel institucional, me qëllim përmirësimin e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e Programit të studimit. <sup>247</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në plotësim të këtij kriteri u konstatua se institucioni organizoi një sërë veprimtarish informuese, sensibilizuese, si dhe evidentuese të problemeve të ndryshme, të planifikuara në planin vjetor të NJSBCVI për personelin dhe studentët. <sup>248</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<sup>246</sup>Evidenca L-Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019.

Raporti i analizës së pyetësorëve, f. 75: <https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>.

<sup>247</sup>Evidenca V.8-Urdhëri Rektorit Nr.123 datë 19.12.2019.

<sup>248</sup>Aktiviteti "Rëndësia e përfshirjes së studentëve në politikën e vlerësimit të UV":

<https://univlora.edu.al/aktivitete/>. Evidenca VI.14 -Plani i punës së NJSBCVI-së për vitet kalendarike 2019 dhe 2020.

## **Përfundime të Vlerësimit të Programit të Studimit të ciklit të parë Bachelor “Biologji”**

### **a. Pikat e forta dhe afirmime**

1. UVI mbështet stafin akademik për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive.
2. UVI ndjek një politikë të qartë dhe gjithmonë publike për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, duke ndjekur periodikisht, duke përdorur metoda dhe instrumenta, si dhe struktura të posaçme të sigurimit të cilësisë, dhe akte rregullatore të posaçme në nivel institucional, duke përfshirë edhe njësitë akademike, personelin dhe studentët.
3. FShTN vë në dispozicion infrastrukturë fizike, didaktike e logjistike të mjaftueshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor, dhe për formimin praktik në gjithë brendinë e Programit.
4. UVI disponon një sistem efektiv të brendshëm të menaxhimit institucional, në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ, përfshirë dhe për Programin e studimit.
5. UVI siguron mbështetje financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e Programit dhe mbështetjen e studentëve në mësim dhe kërkim.
6. UVI ka struktura akademike efikase që shoqërojnë ecurinë e studentit që nga fillimi e deri në pas diplomim

### **b. Pika të dobëta**

1. Nuk del shumë qartë, cili ka qenë studimi fillestar dhe në vijim mbi nevojën e tregut të punës për të diplomuar në këtë Program studimi, si në nivel vendor dhe më gjerë, lidhur me kërkesat e punëdhënësve për forcën e punës për një periudhë aftamesme, dhe mbi politikatat kombëtare të punësimit dhe zhvillimit, si dhe mbi prirjet e numrit të nxënësve që përfundojnë gjimnazet në vite, si brenda Qarkut Vlorë dhe në gjithë Shqipërinë.
2. Nga personeli akademik që merr pjesë në zhvillimin e Programit vihet re ngarkesë relativisht e lartë, në numër lëndësh, në zhvillimin e lëndëve bazë karakterizuese, brenda vetë Programit dhe në FShTN etj. Në vitet e fundit vihen re disa largime të personelit të ri drejt Universitetit të Tiranës.
3. Pavarësisht rritjeve në vitet e fundit, gjendja financiare në UVI mbetet përsëri e ulët krahasuar me sistemin universitar, si atë privat në Shqipëri, dhe sidomos për sistemin universitar në rajon dhe më gjerë. Kjo ndikon edhe në nivelin e përgjithshëm të cilësisë së mësimit dhe kërkimit, në përditësimin e mjediseve laboratorike, dhe të bibliotekës etj., në motivimin e personelit akademik dhe ndihmës etj.

### **c. Rekomandime**

1. GVJ sugjeron që DB të synojë në përshtatjen sa më mirë të Programit me programe homologe me përvojë në vende të BE; të rishohë të gjithë Syllabuset, mundësisht përditësimin e tyre me literaturë bazë dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit, dhe shkrimin e saktë të literaturës. Këto duhet të jenë të dukshme në formë elektronike faqen e UVI, për të ndihmuar më mirë kandidatët e jashtëm për t'u njohur me këtë Program dhe përmbajtjen lëndore dhe të tjera të dhëna.




2. GVJ sugjeron që DB të rishohë që numri i lëndëve dhe i ngarkesës mësimore vjetore të personelit të jetë në përputhje me U29 (MASR, 2018).
3. GVJ sugjeron që DB të shmangë zhvillimin e lëndëve me përmbajtje nga fusha shkencore jo të afërta nga i njëjti personel efektiv; të përpiqet që titullarët e lëndëve karakterizuese në Program të mbulohen të paktën nga personel me gradë shkencore; të shohë mundësinë që lëndë të tilla si: Ekologjia, Paleontologji & Bazat e Gjeologjisë/Fitogjeografi, Hidrobiologji të mund të kenë të paktën disa ditë praktikë në terren.
4. Për të bërë dallimin dhe nxitjen mes personelit ka rëndësi përdorimi i treguesve më të qartë dhe më të matshëm, mundësisht të institucionalizuara edhe në rregulloret përkatëse, përfshirë këtu edhe promovimin e arritjeve më të mira. GVJ sugjeron që DB të shohë mundësinë për të shtuar numrin e personelit akademik të kualifikuar dhe atij ndihmës për të ulur ngarkesën dhe realizimin e duhur të mësimdhënies. Në Vlorë ka më shumë mundësi bashkëpunimi lidhur me mbarëvajtjen e Programit dhe të Masterave që rrjedhin prej tij.
5. Kërkohen më shumë përpjekje për pranime në vitin e parë, në numër dhe sa më cilësore, duke njohur më mirë tregun e punës, dhe përshtatjen e Programit dhe të programeve master në vijim në përputhje me kërkesat e tregut vendor dhe më gjerë. GVJ sugjeron që DB të bëjë më shumë përpjekje për t'u njohur me propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, në funksion të përmirësimit të Programit dhe përshtatjen me tregun e punës
6. Këshillojmë që UVI të sanksionojë në rregulloret përkatëse, të kontrollojë dhe dokumentojë në mënyrë periodike shkallën e sigurisë/saktësisë së ruajtjes së sistemit të vlerësimit (notave), përputhjen e informacionit të vlerësimeve nëpërmjet procesverbaleve të personelit akademik me ato të Regjistrit themeltar dhe sistemit elektronik UVMS, parandalimin e gabimeve qoftë edhe njerëzore, si dhe promovimin për auditimet me saktësi të lartë.
7. GVJ sugjeron që UVI dhe MASR nuk duhet të reshtin përpjekjet për të shëndoshur të ardhurat financiare në dobi të zhvillimit cilësor të mësimi dhe të kërkimit, përfshirë këtu edhe pagesë më të mirë të stafit akademik dhe ndihmës. Në këtë drejtim, duhen më shumë përpjekje në mbështetjen, nxitjen për kualifikim dhe sigurimin e kushteve për personelin e ri, por dhe për të gjetur rrugët e duhura ligjore që të prandaluar rrjedhjen e trurit nga institucioni.

## Conclusions of the Evaluation of the study program of the first Bachelor cycle "Biology"

### a. Strong points and affirmations

1. UVI supports academic staff to perform tasks efficiently and effectively.
2. UVI pursues a clear and always public policy for guaranteeing and promoting the quality of teaching, professional and scientific training with best methods and practices, following periodically, using methods and instruments, as well as special quality structures, special regulatory acts at the institutional level, including academic units, staff and students.
3. The faculty provides available physical, didactic and logistical infrastructure sufficient for the successful implementation of teaching and scientific activity, and for practical training throughout the Program.


4. UVI has an effective internal system of institutional management, available for the administration, information and monitoring of academic, financial and administrative activity, including the Study Program.
5. UVI provides the necessary financial support for the progress of the Program and the support of students in teaching and research.
6. UVI has efficient academic structures that accompany the student's progress from the beginning till after the graduation.

#### **b. Weak points**

1. It is not very clear what was the initial and subsequent labor market study on the need of study program graduates, both at the local level and beyond, regarding the demands of employers for the labor force for a medium period, and on national employment and development policies, as well as on trends in the number of students graduating from high schools per year, both within the Vlora Region and throughout Albania.
2. From the academic staff that participates in the development of the Program, there is a relatively high workload, in the number of subjects, in the development of basic characterization subjects, within the Program itself and in the faculty, etc. In recent years there have been some departures of new staff towards the University of Tirana.
3. Despite the increases in recent years, the financial situation at UVI remains low compared to the university system, both the private ones in Albania the university system in the region and beyond. This also affects the overall level of quality of teaching and research, the updating of laboratory facilities, and the library, etc., the motivation of academic and support staff, etc.

#### **c. Recommendations**

1. EEG suggests that BD aims at better adapting the Program to experienced counterpart programs in EU countries; review all Syllabuses, possibly updating them with basic and recommended literature of the last 5 years, and correct format writing of the literature. These should be visible electronically on the UVI website, to better assist external candidates to familiarize themselves with this Program and the subjects and other content provided.
2. EEG suggests that BD review the number of courses and the annual teaching load of the staff to be in accordance with U29 (MASR, 2018).
3. EEG suggests that BD avoid the development of subjects with content from scientific fields not close by the same effective personnel; try to ensure that the holders of the characteristic courses in the Program are covered at least by staff with scientific degrees; see the possibility that subjects such as: Ecology, Paleontology & Basics of Geology / Phytogeography, Hydrobiology may have at least a few days of field practice.
4. In order to distinguish and encourage staff, it is important to use clearer and more measurable indicators, possibly institutionalized in the relevant regulations, including the promotion of best performance. EEG suggests that BD see the possibility of increasing the number of qualified academic and support staff to reduce the workload and proper teaching delivery. In Vlora there




are more opportunities for cooperation regarding the progress of the Program and the Masters deriving from it.

5. More efforts are required for admissions in the first year, in number and as high quality as possible, better knowing the labor market, and adapting the Program and the following master programs in accordance with the demands of the local market and beyond. EEG suggests that BD make more efforts to get acquainted with the proposals of collaborators and partners from the labor market, in order to improve the Program and adapt to the labor market.

6. We advise UVI to sanction in the relevant regulations, to check and document periodically the degree of security / accuracy of the maintenance of the evaluation system (grades), the compliance of the evaluation information through the minutes of the academic staff with those of the Basic Register and the electronic system UVMS, prevention of human errors, as well as promotion for high-precision audits.

7. EEG suggests that UVI and MASR should not stop trying to increase financial income for the benefit of quality teaching and research development, including better pay for academic and support staff. In this regard, more efforts are needed to support, promote qualifications and provide conditions for new staff, but also to find appropriate legal avenues to prevent brain drain from the institution.



## Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushje n pjesërisht	Përbushje n kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X